

RELACION TEKNIK I MBROJTJES NDAJ ZJARRIT “MNZ”

PROJEKT ZBATIM OBJEKTI :
“STUDIM PROJEKTIM PARKU URBAN - SPITALLË”



AUTOR I PROJEKTIT

BOE“IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION (I.C.P)” Sh.p.k
& “HYDRO-ENG CONSULTING” sh.p.k

Ing.Alban DAUTAJ

Licence Nr.K.2232/2

Certifikate “Ekspert Zjarrefikes Privat”, Nr.68 date 08/11/2023

AUTOR I PROJEKTIT

**BOE “IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION (I.C.P)” Sh.p.k
& “HYDRO-ENG CONSULTING” sh.p.k**

Licence Nr.N.7001/3

Licence Nr.N.7049/4

Titulli i Projektit: “ **Studim projektimi parku urban Spitallë**”
Përgatitur nga:

IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION (I.C.P)” Sh.p.k

Rruga Aleksandër Goga, Lagjja nr. 18, Durrës

Mob: +355 693100570

E-mail: icp.alban@outlook.com

HYDRO-ENG CONSULTING shpk

Rruga Ahmet Ramzoti, Lagja nr.18, Rajoni nr.5, Durrës

Mob: +355 69 386 71 72

E-mail hydroeng.consulting@gmail.com

Kontratë “Shërbim Konsulencë”: Nr.93/2 Prot, Datë 25.01.2024

Grupi i Projektimit:

Ing.Ndërtimi -Ing.Alban DAUTAJ

Ing.Elektrik-Ing.Edmond PALODHI

Ing.Hidrotëknik-Ing.Evis QYRKU

Ing.Hidrotëknik-Ing.Xhuljana (SULA)DAUTAJ

Ing.Ndërtimi-Ing. Jani TATI

Ing.Topograf-Ing.Maksim GEGA

Ing.Mekanik-Ing.Kristaq PRIFTI

Ing.Mjedisi -Ing.Shpetim CIKU

Arkitëkt.Sidrit Foti PRIFTI

Arkitëkt JA.Marc JOUBERT

Arkitëkt.Hellmer RAHMS

Arkitëkt.Kees FRITSCHY

Arkitëktë .Jorida GRABOVARI

Përgatitur për:

Bashkia Durrës, Sheshi “Liria”, Qytëti Durrës

PËRMBAJTJA

1.MBËSHTJELLA LIGJORE DHE NORMATIVE	4
2. TË DHËNAT MBI PROJEKTIN.....	5
2.1DISTANCAE ZJARRËFIKËJA.....	6
3. SISTEMI I SHUARJES ME HIDRANTE	7
4.METODOLOGJIA E LLOGARITJES.....	7
4.1 HUMBJET GJATËSORE.....	7
4.2 HUMBJET LOKALE.....	7
4.3 PRURJA LLOGARITËSE.....	8
5. SPECIFIKIMI TEKNIK TE HIDRATEVE	8
5.1 RRJETI I HIDRANTEVE PERFSHIN	8
5.2 LIDHJA E HIDRANTIT	8

1.MBËSHTJELLA LIGJORE DHE NORMATIVE

Projekti për mbrojtjen ndaj zjarrit dhe Shpëtim për projektin zbatimit për ndërtimin e Parkut Urban -Spitallë është realizuar në bazë të standarteve dhe normave lokale si dhe ato të vendeve të Komunitetit European. Sistemi i mbrojtjes kundër zjarrit respekton të gjitha kërkesat e detyrueshme shtetërore që kanë të bëjnë me normat / standartet që janë në fuqi aktualisht në Shqipëri si dhe normat Europiane.

Ligjet, rregulloret, normat dhe standartet e përdorura në këtë projekt janë paraqitur në vijim:

- Ligji nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit”; Vendim nr.162 datë 19.4.1965, e ripunuar; Për miratimin e “Rregullorja mbi masat e mbrojtjes kundër zjarrit në projektimin e ndërtesave të çdo lloji” Vendim i këshillit të ministrave Nr.699, dt 22.10.2004
- Për “Miratimin e rregullave teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin në konstruksionet dhe ndërtimet, që shërbejnë për veprimtari akomoduese turistike” Vendim I këshillit të ministrave Nr.626, dt15.07.2015,”Për miratimin e normativave të projektit të banesave, Udhezim i Ministrit te Punëve të Brendëshme nr.425 datë 24.7.2015 “Për pranimin, administrimin e dokumentacionit teknik dhe grafik të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin dhe lëshimin e akteve teknike” Urdhër i Ministrit Pushtetit Vendor e Decentralizimit Nr..45 dt 09.04.2004, “ Për miratimin e rregullores “Për masat e mbrojtjes nga zjarri në depo dhe magazina të ndryshme”
- EN 13501 Fire classifications of construction products and building elements (all parts).
- EN 14384.
- EN 1074/6.
- EN1092-2.



Figura Nr.1 Planvendosja e projektit

2. TË DHËNAT MBI PROJEKTIN

Zona ku do të kryhet investimi ndodhet në veri-perëndim të qytetit dhe përfshin lagjen 8 dhe 15, zona Spitallë. Pozicionohet në pjesën kodrinore të qytetit, që përfshin aksin rrugor dhe hapësirat publike rreth nga rruga “Pjetër Bogdani” deri në rrugën “Syri i Detit” në zonën e Spitallës në qytetin e Durrësit. Sipërfaqja që do të zihet nga ky rikualifikim urban është 10 000 m² park urban dhe 20 000 m² sipërfaqe rruge.

Kjo zonë e cila karakterizohet nga rritja e numrit të popullsisë si rezultat i ndryshimeve demografike që ka pësuar në periudhën e pas viteve 90-të. Popullsia llogaritet 168,000 banorë.

2.1 Distanca nga Zjarrefikësja

Zona ku do të kryhet investimi ndodhet 3.2 km larg nga Godina e Zjarrefikësës nga seksioni verior i parkut dhe 2.5 km larg nga seksioni jugor i parkut.

RELACION TEKNIK PER OBJEKTIN “STUDIM PROJEKTIM PARKU URBAN - SPITALLE”




Figura Nr.2 Distanca nga seksioni verior i parkut deri tek zjarrëfiksja Durrës.



Figura Nr.3 Distanca nga seksioni jugor i parkut deri tek zjarrëfiksja Durrës.

3 SISTEMI I SHUARJES ME HIDRANTE

Ky sistem është i tipit me shuarje me ujë dhe funksionimi i tij bëhet i mundur në sajë të furnizimit me ujë nga rrjeti publik i ujësjellësit. Në llogaritjen dhe dimensionimin e impiantit, janë marrë në konsideratë normat e rekomanduara EN 14384; EN 1074-6. Hidrantet do të jenë të dukshëm dhe lehtësisht të arritshëm. Në projekt hidrantet do të vendosen në afërsi të intersektimeve rrugore përgjatë parkut për të dhënë më shumë akses zjarrëfikëses në rast zjarri si brënda dhe jashtë zonës së parkut.

Duhet theksuar që përgjatë parkut i është lënë akses rruge zjarrëfikëses për çdo seksion të parkut. Hidrantët duhet të jenë të pajisur me një ose më shumë hyrje uji valvol moskthimi për të mos lejuar daljen e ujit, shkarkues uji për të evituar ngrirjen e tuba cioneve dhe të jenë të mbrojtur nga goditjet. Presioni nominal i sistemit nuk duhet të jetë më i vogël se presioni maksimal (1.2 MPa).

4. METODOLOGJIA E LLOGARITJES

Llogaritja hidraulike e rrjetit të tuba cioneve bën të mundur dimensionimin e çdo pjesë në bazë të humbjeve hidraulike gjatësore dhe lokale që i përkasin asaj pjese. Ajo kryhet mbi bazën e të dhënave gjeometrike (gjatësia e pjesëve të rrjetit, disnivelet gjeodezike, diametrat nominalë të tuba cioneve) duke çuar në përcaktimin e të gjitha karakteristikave hidraulike të pjesëve (prurja, humbjet gjatësore dhe lokale) dhe më pas të presionit dhe prurjes totale dhe të fuqisë minimale të pompës që do të instalohet në pikën fillestare të rrjetit. Më pas, do të bëhet edhe verifikimi i shpejtësisë maksimale të ujit në të gjitha pjesët e rrjetit e cila nuk duhet të jetë më e madhe se 10 m/s.

4.1 Humbjet gjatësore

Humbjet hidraulike gjatësore do të llogariten me formulën Hazen-Williams:

$$H_g = 60500000 \times \frac{L \times Q^{1.85}}{C^{1.85} \times D^{4.87}}$$

ku: 60500000 = koeficienti i Hazen-Williams sipas sistemit SI (presioni në MPa);

H_{gj} = humbjet gjatësore (bar);

Q = prurja përkatëse e pjesës (l /min);

L = gjatësia gjeometrike e pjesës (m);

D = diametri i tubit (mm);

C = koeficienti i ashpërsisë.

Përshkrimi	C (i ri)	C (i përdorur)
AM0 - çelik i pa lidhur UNI EN 10255 Seria Mesatare	120	84
P11 - Polietilen PE 100 PN 16 UNI 10910-2 SDR 11	150	105

4.2 Humbjet lokale

Humbjet lokale ndodhin për shkak të rakorderive, brrylave, lidhjeve T dhe kryqeve, ku kalimi i fluksit pëson një ndryshim 45 ° ose më të madh (me përjashtim të brrylave dhe lidhjeve T që janë montuar direkt tek erogatorët). Ato kthehen në "gjatësi ekuivalente tubacioni" siç

specifikohet në normën UNI 10779 dhe i shtohen gjatësisë reale të tubacionit me diametër dhe natyrë të njëjtë. Përcaktimi i humbjeve lokale do të bëhet duke mbajtur parasysh:

- Kur fluksi kalon në një T ose lidhje kryq pa ndryshim drejtimi, humbjet hidraulike mund të neglizhohen;
- Kur fluksi kalon në një T ose lidhje kryq pa ndryshim të drejtimit, por me reduktim seksioni, do të merret në konsideratë " gjatësia ekuivalente " e llogaritur për seksionin e daljes së lidhjes;
- Kur fluksi pëson një ndryshim drejtimi (brryl, T ose lidhje kryq) do të merret në konsideratë " gjatësia ekuivalente " e llogaritur për seksionin e daljes.

Për llogaritjet, paraprakisht vendoset presioni minimal që duhet siguruar në secilën pikë fundore (hidrant). Në funksion të prurjes minimale të përcaktuar nga norma, procedohet me zgjedhjen korrekte të koeficientit të efluksit (prurjes), në përputhje me ata në treg dhe të dhënë nga konstruktorët sipas normave BE. Llogaritjet hidraulike do të përcaktojnë, për çdo hydrant të konsideruar aktiv, dhe në funksion të K të vendosur, presionin real dhe rrjedhimisht, prurjen reale. Për thjeshtësi të llogaritjeve, mund të merren në konsideratë vetëm ata hidrantë që, sipas normës, gjatë funksionimit të tyre të njëkohshëm, duhet të garantojnë në dalje të hundezës më të sfavorizuar, kushtet hidraulike minimale të përmendura më sipër.

4.3.Prurja llogaritëse

Prurja e llogaritur e cila nevojitet për furnizimin me ujë për hidrantët në pikën e lidhjes është prurja e përcaktuar në relacionin e specifikimeve teknike në bazë të karakteristikave të hidranteve.

5. Specifikimet teknike të hidranteve:

Në projekt do të vendosen 3 hidrant rrugor mbi toke prej gize(GJS), lidhja me fllanxha sipas standartit EN 1074-6, presioni i punës 10/16 bar, shkarkim automatik për boshatisje kundër ngricës, kapuç manovrimi i unifikuar i manovrueshëm me çelës, unazat izoluese dhe aksi prej tunxhi, fllanxha e bazës UNI EN1092-2 (ISO 7005-2), PN16, me tre dalje për ujë deri në maksimum 60° C.

5.1 Rrjeti i hidranteve përfshin:

- Furnizimin hidrik;
- Rrjetin e tubacioneve nga pika e lidhjes me rrjetin e ujësjellësit ;

5.2 Lidhja e hidrantit

Hidrantet do të lidhen me rrjetin e jashtëm të ujësjellësit.

Në zonën ku do të ndërtohet parku është parashikuar të kalojë rrjeti i ujësjellësit si më poshtë :

1-Në seksionin veri kalon tubacioni OD110mm PE PN 16.

2-Në seksionin jugor kalon tubi i ujësjellësit OD 110 mm PN 16 dhe Tubi OD 90 mm Pn 16.



Figura Nr.4 Planimetria e përgjithshme e vendosjes së hidranteve.




Figura Nr.5 Skema e lidhjes me rrjetin e ujës jellësit hidranti nr.1

INSTALIMI I HIDRANTEVE MBI TOKE

SEKSIONI TERTHOR




Figura Nr.6 Skema e lidhjes me rrjetin e ujësjetës hidranti nr.2




Figura Nr.7 Skema e lidhjes me rrjetin e ujësjetës hidranti nr.3

Për tubacionet duhen patur parasysh veçoritë e mëposhtme:

- Duhet siguruar mbrojtja antikorrozion;
- Rezistencë mekanikë e lartë ndaj korrozionit;
- Rezistencë ndaj ngricave;
- Duhet të jenë të mbrojtura nga veprimet sizmike;

PËRGATITI :

Ing.Alban DAUTAJ

Licence Nr.K.2232/2

Certifikate “Ekspert Zjarrefikes Privat”, Nr.68 date 08/11/2023

Plani i Shpronësimeve
OBJEKTI "STUDIM PROJEKTIM, PARKU URBAN - SPITALLË"

POROSITESI :

BASHKIA DURRES


PROJEKTUES :

BOE"IDEAL CONSTRUCTION & PROJECTION"(I.C.P) sh.p.k

"HYDRO-ENG CONSULTING " sh.p.k




PLANI I SHPRONESIMEVE N.1 SH 1: 500



- Legjenda:**
- - Sipërfaqja për shpronësim
 - - Konturi i Prones
 - - Konturi i Godines
 - - Kontur Rruge Ekzistuese

PLANI I PERGJITHSHEM SH 1: 3500




O B J E K T I

"STUDIM PROJEKTIM PARKU URBAN - SPITALLË"

POROSITESI :

BASHKIA DURRES



PROJEKTUES :

"IDEAL CONSTRUCTION & PROJECTION"(I.C.P) sh.p.k



"HYDRO-ENG CONSULTING " sh.p.k



GRUPI I PROJEKTIMIT

Drejtes ligjor	Ing.Alban DAUTAJ	Nr. Licence K.2232/2
Ing.Elektrik	Edmond PALODHI	Nr. Licence E.1552
Ing.Hidroteknik	Evis QYRKU	Nr. Licence K.1829/2
Ing.Hidroteknik	Xhuljana (Sula)DAUTAJ	Nr. Licence K.3161
Ing.Ndertimi	Jani TATI	Nr. Licence K.2752/1
Ing.Topograf	Maksim GEGA	Nr. Licence T.0455/4
Ing.Mekanik	Kristaq PRIFTI	Nr. Licence E.0431/1
Ing.Mjedisi	Shpetim CIKU	Nr. Licence A.2443/ Cert Nr.5077 Prot. date 08.07.2013
Arkitekt	Sidrit Foti PRIFTI	Nr. Licence A.1849/1
Arkitekt	JA.Marc JOUBERT	
Arkitekt	Hellmer RAHMS	
Arkitekt	Kees FRITSCHY	
Arkitekt	Jorida GRABOVARI	

FIRMA/VULA


TE DHENA TEKNIKE

FAZA E PROJEKTIT	PROJEKT ZBATIM
TIPI I FLETES	
EMERTIMI I FLETES	Plan Shpronimese n.1 1:500

Nr. i fletes **A-01**




PLANI I SHPRONESIMEVE N.2 SH 1: 500



- Legjenda:**
- - Sipërfaqja për shpronësim
 - - Konturi i Prones
 - - Konturi i Godines
 - - Kontur Rruge Ekzistuese

PLANI I PERGJITHSHEM SH 1: 3500



O B J E K T I

"STUDIM PROJEKTIM PARKU URBAN - SPITALLË"

POROSITESI :

BASHKIA DURRES



PROJEKTUES :

"IDEAL CONSTRUCTION & PROJECTION"(I.C.P) sh.p.k



"HYDRO-ENG CONSULTING " sh.p.k



GRUPI I PROJEKTIMIT

Drejtues ligjor	Ing.Alban DAUTAJ	Nr. Licence K.2232/1
Ing.Elektrik	Edmond PALODHI	Nr. Licence E.1552
Ing.Hidroteknik	Evis QYRKU	Nr. Licence K.1829/2
Ing.Hidroteknik	Xhuljana (Sula)DAUTAJ	Nr. Licence K.3161
Ing.Ndertimi	Jani TATI	Nr. Licence K.2752/1
Ing.Topograf	Maksim GEGA	Nr. Licence T.0455/4
Ing.Mekanik	Kristaq PRIFTI	Nr. Licence E.0431/1
Ing.Mjedisi	Shpetim CIKU	Nr. Licence A.2443/ Cert Nr.5077 Prot. date 08.07.2013
Arkitekt	Sidrit Foti PRIFTI	Nr. Licence A.1849/1
Arkitekt	JA.Marc JOUBERT	
Arkitekt	Hellmer RAHMS	
Arkitekt	Kees FRITSCHY	
Arkitekt	Jorida GRABOVARI	

FIRMA/VULA

TE DHENA TEKNIKE

FAZA E PROJEKTIT	PROJEKT ZBATIM
TIPI I FLETES	
EMERTIMI I FLETES	Plan Shpronetime n.2 1:500

Nr. i fletes **A-02**




PLANI I SHPRONESIMEVE N.3 SH 1: 500

O B J E K T I

"STUDIM PROJEKTIM PARKU URBAN - SPITALLË"

POROSITESI :

BASHKIA DURRES



PROJEKTUES :

"IDEAL CONSTRUCTION & PROJECTION"(I.C.P) sh.p.k



"HYDRO-ENG CONSULTING" sh.p.k



GRUPI I PROJEKTIMIT

Drejtes ligjor	Ing.Alban DAUTAJ	Nr. Licence K.2232/1
Ing.Elektrik	Edmond PALODHI	Nr. Licence E.1552
Ing.Hidroteknik	Evis QYRKU	Nr. Licence K.1829/2
Ing.Hidroteknik	Xhuljana (Sula)DAUTAJ	Nr. Licence K.3161
Ing.Ndertimi	Jani TATI	Nr. Licence K.2752/1
Ing.Topograf	Maksim GEGA	Nr. Licence T.0455/4
Ing.Mekanik	Kristaq PRIFTI	Nr. Licence E.0431/1
Ing.Mjedisi	Shpetim CIKU	Nr. Licence A.2443/ Cert Nr.5077 Prot, date 08.07.2013
Arkitekt	Sidrit Foti PRIFTI	Nr. Licence A.1849/1
Arkitekt	J.A.Marc JOUBERT	
Arkitekt	Helmer RAHMS	
Arkitekt	Kees FRITSCHY	
Arkitekt	Jorida GRABOVARI	

FIRMA/VULA


TE DHENA TEKNIKE

FAZA E PROJEKTIT	PROJEKT ZBATIM
TIPI I FLETES	
EMERTIMI I FLETES	Plan Shpronesime n.3 1:500

Nr. i fletes **A-03**

- Legjenda:**
- - Sipërfaqja për shpronësim
 - - Konturi i Prones
 - - Konturi i Godines
 - - Kontur Rruge Ekzistuese

PLANI I PERGJITHSHEM SH 1: 3500






PLANI I SHPRONESIMEVE N.4 (AKSES I PROPOZUAR) SH 1:500

O B J E K T I

"STUDIM PROJEKTIM PARKU URBAN - SPITALLË"

POROSITESI :

BASHKIA DURRES



PROJEKTUES :

"IDEAL CONSTRUCTION & PROJECTION"(I.C.P) sh.p.k



"HYDRO-ENG CONSULTING" sh.p.k



GRUPI I PROJEKTIMIT


Drejtes ligjor	Ing.Alban DAUTAJ	Nr. Licence K.2232/1
Ing.Elektrik	Edmond PALODHI	Nr. Licence E.1552
Ing.Hidroteknik	Evis QYRKU	Nr. Licence K.1829/2
Ing.Hidroteknik	Xhujana (Sula)DAUTAJ	Nr. Licence K.3161
Ing.Ndertimi	Jani TATI	Nr. Licence K.2752/1
Ing.Topograf	Maksim GEGA	Nr. Licence T.0455/4
Ing.Mekanik	Kristaq PRIFTI	Nr. Licence E.0431/1
Ing.Mjedisi	Shpetim CIKU	Nr. Licence A.2443/ Cert Nr.5077 Prot, date 08.07.2013
Arkitekt	Sidrit Foti PRIFTI	Nr. Licence A.1849/1
Arkitekt	JA.Marc JOUBERT	
Arkitekt	Helmer RAHMS	
Arkitekt	Kees FRITSCHY	
Arkitekt	Jorida GRABOVARI	

FIRMA/VULA

TE DHENA TEKNIKE


FAZA E PROJEKTIT	PROJEKT ZBATIM
TIPI I FLETES	
EMERTIMI I FLETES	Plan Shpronesime n.4 1:500

Nr. i fletes **A-04**



- Legjenda:**
- - Sipërfaqja për shpronësim
 - - Konturi i Prones
 - - Konturi i Godines
 - - Kontur Rruge Ekzistuese

PLANI I PERGJITHSHEM SH 1:3500



PLANI I SHPRONËSIMEVE

PROJEKT ZBATIM OBJEKTI : “STUDIM PROJEKTIM PARKU URBAN - SPITALLË”



AUTOR I PROJEKTIT

BOE“IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION (I.C.P)” Sh.p.k
& “HYDRO-ENG CONSULTING” sh.p.k

Licence Nr.N.7001/3

Licence Nr.N.7049/4

Titulli i Projektit: “ **Studim projektimi parku urban Spitalle**”

Përgatitur nga:

IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION (I.C.P)” Sh.p.k
Rruga Aleksandër Goga, Lagja nr. 18,Durrës
Mob: +355 693100570
E-mail:icp.alban@outlook.com

HYDRO-ENG CONSULTING shpk
Rruga Ahmet Ramzoti, Lagja nr.18, Rajoni nr.5, Durrës
Mob: +355 69 386 71 72
E-mail hydroeng.consulting@gmail.com

Kontratë “Shërbim Konsulencë”: Nr.93/2 Prot, Datë 25.01.2024

Grupi i Projektimit:

Ing.Ndërtimi -Ing.Alban DAUTAJ
Ing.Elektrik-Ing.Edmond PALODHI
Ing.Hidrotëknik-Ing.Evis QYRKU
Ing.Hidrotëknik-Ing.Xhuljana (SULA)DAUTAJ
Ing.Ndërtimi-Ing. Jani TATI
Ing.Topograf-Ing.Maksim GEGA
Ing.Mekanik-Ing.Kristaq PRIFTI
Ing.Mjedisi -Ing.Shpetim CIKU
Arkitëkt.Sidrit Foti PRIFTI
Arkitëkt JA.Marc JOUBERT
Arkitëkt.Hellmer RAHMS
Arkitëkt.Kees FRITSCHY
Arkitëktë .Jorida GRABOVARI

Përgatitur për:

Bashkia Durrës, Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës

PËRMBATJE

1.	PËRSHKRIM I PËRGJITHSHEM I PROJEKTIT.....	4
2.	SYNIMET/OBJEKTIVAT.....	5
3.	KRITERET LIGJORE PËR VLERËSIMIN E PRONËSISË.....	5
4.	METEDOLOGJIA.....	6
5.	ANALIZA TEKNIKE (Projekti Teknik / Zgjidhja Teknike / Fizibiliteti Teknik).....	7
	5.1 Analiza e Shpronësimeve.....	7
	5.2 Përpjekjet për të pakësuar shpronësimet.....	7
	5.3 Vlerësimi dhe kompensimi.....	7

TABELA E FIGURAVE

<i>Figura Nr.1 Planvendosja e projektit.....</i>	<i>4</i>
<i>Figura nr.2 Paraqitje skematike e gjurmës së projektit së bashku me zonat kadastrale....</i>	<i>7</i>

1. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHEM I PROJEKTIT

Projekti për ndërtimin e parkut urban Spitallë ndodhet në veri-perëndim të qytetit dhe përfshin lagjen 8 dhe 15, zona Spitallë. Pozicionohet në pjesën kodrinore të qytetit, që përfshin aksin rrugor dhe hapësirat publike rreth nga rruga “Pjetër Bogdani” deri në rrugën “Syri i Detit” në zonen e Spitallës në qytetin e Durrësit. Sipërfaqja që do të zihet nga ky rikualifikim urban është 10 000 m² park urban dhe 20 000 m² sipërfaqe rruge. Parku do të ndërtohet në një zonë të banuar në të cilën popullsia llogaritet 168,000 banorë. Sipërfaqja që do të zihet nga ky rikualifikim urban është 10 000 m² park urban dhe 20 000 m² sipërfaqe rruge.

Në vitet 2019-2020 Bashkia Durrës ka realizuar investimin me objekt “Rehabilitim i Kanalit KUL, faza II dhe faza III”, i cili ka realizuar ndërtimin e kanalit të mbyllur me strukturë beton – arme. Mbulimi i këtij kanali është zgjedhur si alternativa më e mirë që do të shërbejë si rrugë lidhëse me rrugën kryesore “A.Goga”.

Gjithashtu aktualisht Bashkia Durrës po zbaton investimin me objekt “Rehabilitimi i Infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto-Romanos - Kënetë dhe sistemimi i rrjetit të ujrave të shiut në zonën urbane të Qytetit të Durrësit, Faza I”.

Të dyja këto investime kanë lidhje me të njëjtin kanal i cili është mbyllur për një gjatësi prej 1.08 km ku kërkohet të zhvillohet dhe projekti në fjalë për Parkun Urban Spitallë.



Figura Nr.1 Planvendosja e projektit.

2.SYNYMET/OBJEKTIVAT

Synimet e këtij projekti janë realizimi i një zone rekreative në hapësirat publike të përfitur nga mbyllja e kanalit KUL, me krijimin e hapësirave të gjelbëruara mbi të me mbjelljen e pemëve, vendosja e disa stolave për pushim, krijimin e disa parqeve me kënde lojërash për fëmijë, etj.

Zhveshja e të gjithë zonës nga bimësia për shkak të ndërtimeve informale pa kriter dhe pa një studim urbanistik për perspektivën e infrastrukturës të zonës, ka shkaktuar shfaqjen e fenomenit të përmytjeve në periudha rreshjesh atmosferike.

Nisur nga rëndësia e këtij projekti si dhe qëllimi për të cilën ai është menduar, është realizuar mbulimi i kanalit kullues duke marrë në konsideratë edhe sezonin e rreshjeve atmosferike, për t'i paraprirë çdo fenomeni të mundshëm.

Gjithashtu në gjëndjen ekzistuese rruga automobilistike nuk është e asfaltuar, mungojnë korsitë e biçikletave, hapësirat për lëvizjen dhe qëndrimin e kalimtarëve, hapësirat rekreative për grupmosha të ndryshme dhe një gjelbërim i sistemuar.

3.KRITERET LIGJORE PËR VLERËSIMIN E PRONËSISE

VKM Nr. 138, datë. 23.03.2000, parashikon kriteret ligjore për vlerësimin e pronave të prekura nga shpronësimi.

- Toka: Vlerësimi i tokës së shpronësuar do të përcaktohet për tokat urbane, tokat brënda vijës së verdhë të qytetit dhe pronat në njësitë vendore sipas çmimeve të miratuara me VKM që rrjedhin nga ligji me Nr. 9235, datë. 29.07.2004 „Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave Private”.
- Pronat Rezidenciale: Vlera e kompensimit të shpronësimit për pronat rezidenciale (banesat) konsiderohet çmimi mesatar i shitjes, sipas të dhënave të Zyrës së regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ZRPP.
- Pronat Industriale dhe Bujqësore: Vlera e kompensimit të shpronësimit për pronat industriale dhe bujqësore konsiderohet çmimi mesatar I shitjes, sipas të dhënave të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, ose Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave. Amortizimi I pasurisë duhet të zbritet nga çmimi.
- Toka Bujqësore, zona pyjore, etj.: Vlera e vlerësimit të tokave bujqësore, zonave pyjore dhe kullotave është përcaktuar nga çmimet e miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me ligjin Nr.9235, datë.29.07.2004 „për kthimin dhe kompensimin e tokave private”. Në raste kur nuk ka çmime të miratuara për rajone të caktuara, vlerësimi për tokat bujqësore, zonat pyjore dhe kullotat përcaktohet nga çmimi mesatar i shitjes i vënë në dispozicion nga ZRPP.
- Pemët Frutore: Për pemët frutore, vlera e parashikuar është e llogaritur duke marrë parasysh kostot e investimeve dhe shpenzimet. Kjo vlerë është përllogaritur për njësi (nr i pemëve frutore) ose njësi për sipërfaqen e tokës (m² vreshtat etj). Investimi I pranishëm në tokë, shpenzimet totale dhe faktorë të ndryshëm të amortizimit janë parashikuar nga Ministria e Bujqësisë, zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.
- Të korrat: për të korrat, vlera është përllogaritur në bazë të rendimentit që pritët dhe të çmimit të tregut për njësi.

4. METEDOLOGJIA

Metedologjia e përdorur nga studio projektuese BOE“IDEAL CONSULTING AND PROJECTION ”(I.C.P)Shpk & HYDRO-ENG CONSULTING Shpk përfshin qasjen pjesëmarrëse të të dhënave cilësore ku janë organizuar vizita në terren, rlevimi topografik i saktë i zonës që do të zhvillohet.

Metedologjia e përdorur për përgatitjen e planit të mundshëm të shpronësimeve është përshkruar më poshtë :

-Vizitat në terren për të studiuar më nga afër zonën dhe diskutimet me banorët e zonës për ti dhënë një zgjidhje sa më efikase projektit si dhe të ketë përjasjen nga të gjithë banorët.

- Harta kadastrale dhe ortografike që identifikuan karakteristikat si zgjidhja e popullsisë, infrastruktura dhe modeli i përdorimit të tokës.

-Pasi është kryer rlevimi i saktë i zonës i është derguar shkresë zyrtare Bashkisë Durrës me Nr.1960 Prot , datë 28/02/2024 per informacion ku jane paraqitur sakte numri i pronave kadastrale pergjate parkut si edhe rlevimi ne CD , për të marë nga ASHK një listë të pronarëve dhe sipërfaqeve përkatëse të pronave.

5. ANALIZA TEKNIKE (Projekti Teknik / Zgjidhja Teknike / Fizibiliteti Teknik)

5.1 Analiza e Shpronësimeve

Analiza kryhet me qëllim investigimin e nevojave ekzistuese dhe të ardhshme në zonën e studimit, duke mbuluar:

Shtrirja gjeografike e projektit dhe përdorimi i tokës:



Parku do të zhvillohet në një hapësirë publike të krijuar nga mbyllja e kanalit te KUL ne një zonë të banuar.Gjurma e projektit kalon përmes një zone urbane si edhe varrezave të vjetra të qytetit të Durrësit.

Llojet e Përdorimit të Tokës

Toka ku do të zhvillohet projekti është mbi kanal in e rehabilituar te KUL (Kanali i mbyllur me strukturë Beton-arme), përgjatë parkut ka intersektime me rrugët automobilistike, kalon përmes zonës së varrezave.

Në hartën e mëposhtëme janë paraqitur gjurma e projektit së bashku me hartat kadastrale të pronave në zonën ku do të kryhet investimi:

PLANI I SHPRONËSIMEVE PËR OBJEKTIN “STUDIM PROJEKTIM PARKU URBAN - SPITALLË”



PLANI I SHPRONËSIMEVE PËR OBJEKTIN “STUDIM PROJEKTIM PARKU URBAN - SPITALLE”



Figura nr.2,3,4,5,6 Paraqitje e projektit se bashku me zonat kadastrale.

5.2 Përpjekjet për të pakësuar shpronësimet

Studiot projektuese nisur nga hapësirat në terren për zhvillimin e parkut urban e kane parë të arsyeshme që parku të zhvillohet sipas rievimit topografik në vënd duke mos prekur zonat përreth tij.

Si variant për ti dhëne një linearitet parkut duke mos patur degëzime janë paraqitur pronat që preken nga shpronësimi. Shpronësimi do të ndikojë gardhe dhe shirita të hollë të oborrit në shtëpitë përgjatë parkut për ti dhëne linearitet hapësirave të gjelbërta.

Shpronësimi i nevojshëm është ai për krijimin e një rrugë të re aksesit për lagjen afër rrugës Syri i Detit për të shmangur kalimin e mjeteve automobilistike në park.

**Shënim: Investitori përpara publikimit të tënderit për ndërtimin e parkut vlerëson dhe vendos variantin me shpronësim ose pa shpronësim për ti dhëne linearitetin e hapësirave të gjelbëruara përgjatë parkut.*

5.3 Vlerësimi dhe kompensimi

Më poshtë është një përmbledhje e paketës së mundshme të kompensimit:

Mungesa e lejeve Titulli: Kur kjo ndodh, shpronësimi mund të përfshijë humbjen e tokës, strehim ose burime të tjera të të ardhurave. Meqë jo të gjithë ndikimet, janë të njohura në fazën e përgatitjes së projektit, ky përfshin shqyrtimin e ndikimeve të mundshme negative nga humbja e strehës dhe zhvendosjes, si dhe humbjen e aktiveve dhe / ose të ardhura (jetesës). Siç tregohet në kriteret për te drejtat për të marrë kompensim, këto do të përfshijnë ata njerëz që janë të zënë ose të përdorin tokën në fjalë, por nuk mund të mbajnë dokumentacionin që tregon të drejtat formale të njohura ligjore mbi tokën apo lejen e ndërtimit.

Humbja e të ardhurave: Nëse më pak se 10-20% e pronës/tokës të një individi ndikohet negativisht nga procesi i blerjes së tokës për një nën-projekt të veçantë, humbje e madhe e të ardhurave nuk pritet dhe ndikimet mund të konsiderohen në përgjithësi të jenë të vogla.

Megjithatë, nëse personat e prekur vuajnë nga humbja e të ardhurave përmes humbjes së më shumë se 20% të mbajtjes së tokës së tyre, zvogëlimi i të ardhurave ka të ngjarë dhe ndihma për rikthimin e të ardhurave do të sigurohet nëse kërkohet. Kjo do të marrë formën e "Ndihmës për Rehabilitim" që do të thotë ndihmë që përfshin vendosjen e vendeve të punës, trajnimin për punë ose formave të tjera të mbështetjes për të mundësuar personat e zhvendosur, të cilët kanë humbur burimin e jetesës si rezultat i zhvendosjes për të përmirësuar ose së paku rivendosjen e tyre nivelet e të ardhurave dhe standardi i jetesës për nivelet e para-projektit.

Humbja e strukturave: Nuk pritet që do të ketë ndonjë strukturë banimi apo strukturë tjetër që do të duhet të merret në vendin e projektit. Megjithatë, në rast se ekzistojnë struktura (hambare, kioska, ndërtesa të vogla tregtare etj.) Që do të duhet të shkatërrohen, "amortizimi" nuk do të përdoret gjatë llogaritjes së kompensimit të pagueshëm për strukturat e prekura dhe personat e prekur do të jenë në gjendje për të zëvendësuar strukturat e tyre me shumën e kompensuar.

Humbja e pronave bashkiake: Siç u përmend më lart, ekzistojnë disa parcela toke që janë prona komunale të cilat duhet të shpronësohen dhe të vihen në dispozicion të projektit. Në këtë rast Këshilli i Ministrave është i detyruar të kompensojë me çmimin e tregut kur prona do të bartet. Gjendja ligjore është e parashikuar shprehimisht me ligjin nr. 10 119, datë 23. 4. 2009 "Për planifikimin territorial" (neni 67).

Vlerësimi i mundshëm i kompesimit		
Përshkrimi	Parashikimi	Komente
Mungesa e lejeve Titulli	Pritet të ndodh	Duhet që AKSH të dorëzojë informacionin e saktë mbi sipërfaqet e pronave.
Humbja e të ardhurave	Nuk pritet të ndodhë	
Humbja e strukturave	Pritet të ndodhë	Gardhe;avulli,Tokë për rrugë akses
Humbja e pronave bashkiake	Pritet të ndodhë	

Shtojca 1. Inventari i pronave qe mund te preken nga projekti

a)Për ruajtjen e linearitetit të hapësirave të gjelbërta

Nr.	Zona Kadastrale	Adresë	Bashkia	Sipërfaqja	Sipërfaqe muri	Lloji i tokës (Bujqësore/tokë)
1	1/108	Spitallë	Durrës	116 m2	35 m	Tokë truall
2	2/24	Spitallë	Durrës	29 m2	27m	Tokë truall
3	2/723	Spitallë	Durrës	20 m2	10 m	Tokë truall
4	2/104	Spitallë	Durrës	23 m2	19 m	Tokë truall
5	2/111	Spitallë	Durrës	46 m2	20 m	Tokë truall
6	2/114	Spitallë	Durrës	19 m2	12 m	Tokë truall
7	2/113	Spitallë	Durrës	10 m2	8m	Tokë truall
8	2/735	Spitallë	Durrës	7 m2	11m	Tokë truall
9	2/741 2/7354	Spitallë	Durrës	10 m2	11 m	Tokë truall
10	2/134	Spitalle	Durres	14 m2	20 m	Tokë truall

b)Për krijim e rrugës së aksesit

Përgjatë gjatësisë së parkut është propozuar krijimi i rruges se aksesit për kalimin e automjeteve për banorët rezident por me akses sipas seksioneve te percaktuara ne skemen e qarkullimit të autojmeteve në projekt zbatimin e projektit .Në seksionin verior të parkut në rrugën Syri i Detit për banorët rezident është lene akses lëvizje duke shmangur sa më shume lëvizjen e mjeteve përgjatë parkut.

Nr.	Zona Kadastrale	Adresë	Bashkia	Sipërfaqja	Lloji i tokës(Bujqësore/tokë)
1	1/113	Spitallë	Durrës	21 m2	Tokë truall
2	1/745	Spitallë	Durrës	6 m2	Tokë truall
3	1/114	Spitallë	Durrës	23 m2	Tokë truall
4	1/747	Spitallë	Durrës	6 m2	Tokë truall
5	1/158	Spitallë	Durrës	228 m2	Tokë truall
6	1/626	Spitallë	Durrës	310 m2	Tokë truall
7	1/584	Spitallë	Durrës	53 m2	Tokë truall
8	1/150	Spitallë	Durrës	15 m2	Tokë truall
9	1/115	Spitallë	Durrës	5 m2	Tokë truall
10	1/118	Spitallë	Durrës	2 m2	Tokë truall

5.3 Sipërfaqet e Prekura nga Projekti

Për çdo pretendim që lidhet me sipërfaqet e prekura nga ndërhyrjet si shkak i hartimit të projektit, pretenduesit duhet të gjejnë zgjidhjen me autoritetin kontraktor, Bashkia Durrës.

PLANI I SHPRONËSIMEVE PËR OBJEKTIN “STUDIM PROJEKTIM PARKU URBAN - SPITALLË”

Shtojca 2: Formular per personat e prekur nga projekti

Projekti Investime / Nën-projektit: _____

Location Qyteti / Bashkia: _____

Data e Studimit: _____.

Projekti Stafi: _____

=====

Numri ID / Case: _____.

Pronar toke, name: _____.

Adresa / kontakti koordinon / telefonit të pronarit të tokës:

Të tjera bashkë-pronarët / shfrytëzuesit e tokës:

Profesioni i pronarit të tokës: _____.

A ndikon marrja e tokës të ardhurat e pronarit të tokës së? _Y / N

=====

Plot Koordinatat / reference kadastrale number _____.

Kadastrale Titulli Status Land: Po (Y), Jo (N); Kontestuar (D).

Përdorimi i tokës: Residential, bujqësore, Biznes, tjera: _____.

type Land: Urban, rural, (përdorin klasifikimet e sakta shqiptare): _____

Madhësia e përgjithshme e komplotit për t'u prekur (m²): _____.

Zona dhe përqindja e komplot që do të merren për projektin (m² /%): _____.

Strukturat apo pasuri të paluajtshme të prekur në zonën që do të merren? (Fences, mure, porta, etj) Y/N.

Është kompensimi financiar të nevojshme për humbjen e përfitimeve ekonomike? (Y / N).

PLANI I SHPRONËSIMEVE PËR OBJEKTIN “STUDIM PROJEKTIM PARKU URBAN - SPITALLË”

Shënime:

Dokumentacioni për çdo person të prekur duhet të përfshijë / verifikuar se:

1. Pronari i tokës (ose prokurë pronari i tokës së) ishte (a) i ftuar në një mënyrë të duhur për të marrë pjesë në anketë; dhe (b) ishte e pranishme / nuk e pranishme për të vëzhguar matjen e zonën e prekur dhe për të diskutuar ndonjë ndikim të përfaqësuar mbi aksesin ose përdorimin e pronës së mbetur.
2. Përcjellja nga specialisti social Projektit me personin e prekur apo parti për të përgatitur një dosje të shkurtër e cila përfshin një listë të të gjitha veprimeve përmirësuese dhe sende që do të rivendoset, zëvendësohet, dhe çdo sende të kompensohen. (Kjo mund të përfshijë ndërtimin e mureve të reja, zëvendësimin e portave, duke hapur dhe peizazhit të nevojshme për të lehtësuar aksesin dhe rivendosjen estetiken, kompensimin për pemët, etj)
3. Pronari i tokës do të nënshkruajë-off për të konfirmuar se prekur matjet sipërfaqja e tokës dhe lista e artikujve rivendosjen dhe veprimet janë të qarta; dhe se shuma e kompensimit për pemë ose ndonjë aseteve ekonomike ose produktive është konfirmuar si reciprokisht të pranueshme për projektin dhe PAP.
4. Sipas KPR: Pagesa e çfarëdo kompensimi monetar, të tilla si për ullinj apo kulturave, duhet të sigurohet për personat e prekur para se toka është marrë për përdorim projektit.

Shtojca 3: Marreveshje me pronarin e tokës

Marrëveshje me pronarin TOKËS

Investime për nën-projekt:

I nënshkruari Z. _____, in _____ banor
vërtetojë se unë jam pronari i tokës / ndërtesë në _____

[Përcaktoni nëse kjo është e lidhur me tokë transferimin, ose nëse ka ndryshime të pronës dhe kompensimit të tokës], siç tregohet në planin e bashkangjitur. Unë gjithashtu vërtetoj se i kam konsultuar nënprojekti projektuesmbikëqyrësit, në bashkëpunim me një anëtar të Follow-up dhe Kontrollit Group) dhe që kam parë dhe diskutuar Projektin finale të zbatimit dhe se kjo efektet Projektit tokës / pronës im dhe unë konfirmoj që unë jam i kënaqur me punët e propozuara dhe përmirësimet e bëra për të zbutur ndikimin e tyre dhe unë plotësisht pajtohem edhe si vijon:

[Përcaktoni llojin e marrëveshjes së pranuar nga Palët] Për më shumë: - Unë autorizoj Kontraktuesit dhe stafin e tij që të kenë të drejtën për të vepruar në tokën / pronën time vetëm për qëllime të zbatimit të punimeve, siç është detajuar dhe i pranuar, dhe në përputhje me programin e miratuar Punëve, me përjashtim të ndonjë emergjence lidhur me punon.

- Autorizoj Bashkia / Komuna / Shoqata _____ dhe përfaqësuesve të tyre zyrtare, si dhe stafin e nevojshëm të _____ për të kanë të drejtë për të vepruar në vendin tim / pronën, në mënyrë për të ndjekur dhe për të matur progresin e punimeve dhe realizimin e tyre sipas projektit pranuar.

- Unë nuk bien dakord për të bllokuar hyrjen e çdo personi, ose Works ose për të vonuar avancimin e tyre, me kusht që punët janë kryer sipas kësaj Marrëveshjeje.

-Unë pajtohem për të informuar GKN për çdo shqetësim që unë mund të ketë lidhje me zbatimin e punimeve dhe nuk do të pengojë Kontraktuesin ose të hyjë në ndonjë marrëveshje formale ose joformale me të në lidhje me zbatimin e Punëve

- I rezervojmë të drejtën për të kërkuar në çdo kohë ka ndryshime në projekt, por unë nuk pajtohem me të pajustificueshme të kundërshtuar këto ndryshime të parashikuara ndryshimet nuk materialisht modifikojnë qëllimin dhe objektivat e punimeve dhe / ose ndikimin e tyre në vendin tim / pronës.

sinqerisht

PLANI I SHPRONËSIMEVE PËR OBJEKTIN “STUDIM PROJEKTIM PARKU URBAN - SPITALLË”

Pronari:

Emri, nënshkrimi mbiemri

Projector-

Mbikëqyrësi _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

PËRGATITI

STAFI TEKNIK BOE “IDEAL CONSULTING AND PROJECTION ”(I.C.P)Shpk

&HYDRO-ENG CONSULTING Shpk

Nr.Licencë N.7001/3;N.7049/4;

Përfaqësues i autorizuar

Ing.Alban DAUTAJ

RAPORT TEKNIK I VLËRËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

“Sudim Projektim Parku Urban -Spitallë”

Zhvillues:Bashkia Durrës,

Projektues: BOE“IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION (I.C.P)” Sh.p.k& “HYDRO-ENG CONSULTING” sh.p.k, përfaqësuar nga Shoqëria I.C.P, përfaqësues i autorizuar Z.Alban DAUTAJ.

Adresa: Rruga Aleksandër Goga, Lagjja nr. 18, Durrës

Baza ligjore:

Sipas VKM Nr. 686, datë:

29.7.2015,“Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisve e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore.

**Raporti i VNM-së u hartua nga:
“HYDRO-ENG CONSULTING”
shpk**

Administrator :Z.Evis QYRKU
Ekspert Mjedisori;Z.Shpëtim ÇIKU
(Nr.lic,A.2443, Nr5077 Prot, Datë
08.07.2013)



1.1 Raportin Teknik të projektit të propozuar, i cili përfshin:

a) Përshkrimi i qëllimit të projektit të propozuar

Qëllimi i këtij projekti është ndërtimi një Parku Urban Linear në zonën e Spitallës në Bashkinë Durrës.

Zona ku do të kryhet investimi ndodhet në veri-perëndim të qytetit dhe përfshin lagjen 8 dhe 15, zona Spitallë. Kjo zonë e cila karakterizohet nga rritja e numrit të popullsisë si rezultat I ndryshimeve demografike që ka pësuar në periudhën e pas viteve 90-të. Popullsia llogaritet 168,000 banorë. Pozicionohet në pjesën kodrinore të qytetit, që përfshin aksin rrugor dhe hapësirat publike rreth nga rruga “Pjetër Bogdani” deri në rrugën “Syri i Detit” në zonen e Spitallës në qytetin e Durrësit. Sipërfaqja që do të zihet nga ky rikualifikim urban është 10 000 m² park urban dhe 20 000 m² sipërfaqe rruge.

Projekti ka si qëllim :

1. Të rigjenerojë zonën si nga ana fizike ashtu edhe nga ana urbane e vizuale;
2. Të ofrojë kushte dhe mundësi më të mira rekreative për banorët;
3. Të nxisë zhvillimin e aktiviteteve rekreative në zonë nëpërmjet nyjeve të posacme rekreative;
4. Të rrisi frekuentimin e zonës ;
5. Të unifikojë vizualisht e funksionalisht zonën.
6. Mbështetja e zhvillimit turistik të qytetit;

Projektuesi ka marrë në konsideratë gjëndjen ekzistuese dhe ka kryer matjet topografike të nevojshme. Projekti u hartua nga Ing.Shpëtim Ciku për llogari të investitorit Bashkia Durrës. Në këtë kontekst u realizua menjëherë njohja e ekspertit me detyrat e projektimit dhe kërkesat specifike me përgjegjësat e Bashkisë Durrës ku shtrihet objekti për evidentimin e saktë të problemeve, zonave problematike dhe propozimin e zgjidhjeve afatmesme dhe afatgjata.

b) Planimetrinë e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen në hartë topografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGE, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë.



Fig.1-Planimetria e zonës ku do të zhvillohet parku urban.

Zona ku do të kryhet investimi ndodhet në veri-perëndim të qytetit dhe përfshin lagjen 8 dhe 15, zona Spitallë. Kjo zonë e cila karakterizohet nga rritja e numrit të popullsisë si rezultat i ndryshimeve demografike që ka pësuar në periudhën e pas viteve 90-të. Popullsia llogaritet 168,000 banorë. Pozicionohet në pjesën kodrinore të qytetit, që përfshin aksin rrugor dhe hapësirat publike rreth nga rruga “Pjetër Bogdani” deri në rrugën “Syri i Detit” në zonen e Spitallës në qytetin e Durrësit. Sipërfaqja që do të zihet nga ky rikualifikim urban është 10 000 m² park urban dhe 20 000 m² sipërfaqe rruge.

Në vitet 2019-2020 Bashkia Durrës ka realizuar investimin me objekt “Rehabilitim i Kanalit KUL, faza II dhe faza III”, i cili ka realizuar ndërtimin e kanalit të mbyllur me strukturë beton – arme. Mbulimi i këtij kanali është zgjedhur si alternativa më e mirë që do të shërbejë si rrugë lidhëse me rrugën kryesore “A.Goga”.

Gjithashtu aktualisht Bashkia Durrës po zbaton investimin me objekt “Rehabilitimi i Infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto-Romanos - Kënetë dhe sistemimi i rrjetit të ujrave të shiut në zonën urbane të Qytetit të Durrësit, Faza I”.

Të dyja këto investime kanë lidhje me të njëjtin kanal i cili është mbyllur për një gjatësi prej 1.08 km ku kërkohet të zhvillohet dhe projekti në fjalë për Parkun Urban Spitallë.

Nga këto dy investime janë përfituar 1.08 km gjatësi hapësirë publike, dhe me qëllim shfrytëzimin maksimal të kësaj hapësire, kërkohet të realizohet një zonë rekreative, me krijimin e hapësirave të gjelbëruara mbi të me mbjelljen e pemëve, vendosja e disa stolave për pushim, krijimin e disa parqeve me kënde lojërash për fëmijë, etj.

Tabela 1: Koordinatat e projektit fillim dhe mbarim linje

	E Gauss Kruger	N Gauss Kruger	E KRGJS H	N KRGJSH
Fillim linje	4369598	4578566	453480	4577525
Fund linje	4369488	4579624	453358	4578575

Raport Teknik i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis



Në gjëndjen ekzistuese rruga automobilistike nuk është e asfaltuar, mungojnë korsitë e biçikletave, hapësirat për lëvizjen dhe qëndrimin e kalimtarëve, hapësirat rekreative për grupmosha të ndryshme dhe një gjelbërim i sistemuar.

Gjatë inspektimit të kryer në terren ishte lehtësisht e dallueshme që e gjithë sipërfaqja ku do të zhvillohet parku linear është një zone e pazhvilluar. Përgjatë të gjithë gjatësisë dallohej betoni i përdorur për të mbyllur kanalën KUL, shkurre, kallamishte, grumbuj me inerte të hedhura, mbeturina të shumta, duke sjellë jo vetëm një pamje të shëmtuar vizuale por edhe ndotëse për ambientin dhe komunitetin përreth.



Raport Teknik i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis



Raport Teknik i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis




Foto nga terreni ku do të ndërtohet parku urban.

c) Informacionin për qendrat e banuara në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, (shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti;

Zona ku shtrihet projekti shtrihet në ndodhet në veri-perëndim të qytetit dhe përfshin lagjen 8 dhe 15, zona Spitalle ne Bashkine Durrës . Pozicionohet në pjesën kodrinore të qytetit, që përfshin aksin rrugor dhe hapësirat publike rreth nga rruga “Pjetër Bogdani” deri në rrugën “Syri i Detit” në zonën e Spitalles në qytetin e Durrësit.

Zona qe u rlevua shtrihet ne nje terren fushor.

Gjatë projektimit të këtij objekti janë marrë parasysh të gjitha rregullat urbane të përcaktuara në VKM në 408, duke respektuar të gjitha parametrat urbane dhe duke mos cënuar privatësinë e komunitetit të kësaj zone. Zona kufizohet nga të dyja anët e saj me ka godina banimi, shtëpi private, me rrugë akses në park.


PLANI I PERGJITHSHEM SH 1: 3500



Planimetri për zonën e banuar

Gjatë fazës së zhvillimit do të ruhen të gjitha distancat sipas legjislacionit ne fuqi. Projekti do të sigurojë respektimin e standarteve ne te gjitha fazat përfshirë dhe zbatimin. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave përkatëse.

ç) skicat dhe planimetritë e objekteve të projektit dhe strukturave të projektit (si dhe mënyrat dhe metodat qe do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit).





PLANI I PERGJITHSHEM SH 1: 3500






- Legjenda:**
- Kendi i llogave per femije
 - Kendi i pjekurit
 - Mjete stacione per te rritur
 - Rruge me tulla (qer shtetas & makina)
 - Hyrjet e shtepive
 - Qelberrim i ulet (mbulimi me bar, lule, shkurre etj)
 - Peme (te medhesive te ndryshme)
 - Kanali KUL (nën tokë-i mbuluar)
 - Kanali per lumbasoret
 - Etoje
 - Hapësira multifunkcionale (ngritje me shkalle - platforma panoramike)
 - Etoje me tulla (nëdim kanali per makina)
 - Hyrje ne pronet private
 - Shtepite e shtruses

PLANI I PERGJITHSHEM SH 1: 3500






- Legjenda:**
- Kendi i llogave per femije
 - Kendi i pjekurit
 - Mjete stacione per te rritur
 - Rruge me tulla (qer shtetas & makina)
 - Hyrjet e shtepive
 - Qelberrim i ulet (mbulimi me bar, lule, shkurre etj)
 - Peme (te medhesive te ndryshme)
 - Kanali KUL (nën tokë-i mbuluar)
 - Kanali per lumbasoret
 - Etoje
 - Hapësira multifunkcionale (ngritje me shkalle - platforma panoramike)
 - Etoje me tulla (nëdim kanali per makina)
 - Hyrje ne pronet private
 - Shtepite e shtruses

PLANI I PERGJITHSHEM SH 1: 3500




Raport Teknik i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis





- Legjenda:
- Kanali i lujave per ferrinj
 - Kanali i pibrikut
 - Mjete shpirtore per te rritur
 - Rruge me kule
 - Iper loketere & rrethore
 - Hyqje & shpirtore
 - Gjelbeshi i ulet
 - Inditore me bar, lule, alkume etj
 - Peme
 - Peme (te modeshive te ndryshme)
 - Kanali KUL
 - (nën tobe-i rrethor)
 - Kalimi per harrbesoret
 - Stole
 - Hapësira multifunksionale
 - (ngjirje me shtraka - platforme peronazhesh)
 - Blloqe me kule
 - (ndajm kalime per makina)
 - Hyrje ne zone private
 - Shpirtore akzozhuese



Planimetri të aksesit të lëvizjes

Raport Teknik i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis

d) përshkrimin e proçeseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese/përpunuese, sasi të lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;

Ky projekt parashikon investime të reja në zonën e Spitallës në bashkinë Durrës.

Nëpërmjet këtij projekti synohet rehabilitimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i zonës. Projekti parashikon krijimin e një parku që do të përbëhet nga linja kalimi këmbësor dhe pista për biçikleta të parashikohet krijimi i stacioneve me pajisje sportive për aktivitete fizike në natyrë. Në zonën e parkut duhet të ketë dhe zona të dedikuara lojërave për fëmijë, si dhe zona për shërbime.

Objektivi i këtij projekti është rikonceptimi i hapësirave publike përgjatë aksit rrugor duke synuar gjenerimin e ambjenteve të jashtme që do të promovojnë jetën në komunitet dhe hapësira të dedikuara për banorët e zonës për aktivitete të ndryshme.

Ndërhyrja e risistemimit të argjinaturës dhe mbyllja pjesore e kanalit kullues, do sjellë shtim të hapësirës të aksesueshme për banorët e zonës. Thelbësore në këtë ndërhyrje është risistemimi i rrjetit kullues të territorit të Bashkisë Durrës. Me këtë ndërhyrje konsolidohet funksionimi i KUZ për këtë zonë të territorit të bashkisë, duke u dhënë përfundimisht zgjidhje edhe mbledhjes së ujërave të shirave.

Një tjetër element i rëndësishëm është shtimi i biomasës në zone, ku parashikohet shtimi i gjelberimit të lartë dhe të ulët përgjatë gjurmës së ndërhyrjes dhe krijimi i xhëpave të gjelbërt të cilat do mundësojnë një hapësirë publike të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve në komunitet.

Përgjatë gjurmës së ndërhyrjes parashikohet ndërtimi i korsisë të bicikletave. Kjo infrastrukturë thjeshtëson aksesin për banorët.

Në përfundim të investimit, banorët e zonës do të kenë mundësi të aksesojnë një hapësirë publike të rikualifikuar e cila përmbush nevojat për zhvillimin e një jete me cilësore. Kjo ndërhyrje do të ndikojë pozitivisht duke rritur ndërveprimin social në komunitet me hapësira të sigurt dhe komode për lëvizshmerinë e të gjitha grupmoshave në një pejsazh të gjelbërt dhe të arduar me facilitetet urbane të përshtatshme.

Proçeset teknologjike në këtë projekt janë ato të fazës ndërtimore, nëpërmjet punimeve të ndërtimit të cilat kryhen nga firma ndërtuese dhe në vija të përgjithshme konsistojnë si më poshtë:

- Rrethimi i sheshit të ndërtimit;
- Pastrimi i sheshit dhe largimi i të gjitha mbetjeve inerte;
- Gërmimi dhe hapja e kanaleve;
- Punime shtresash;
- Shtrim i rrugëve me tulla;
- Punime rrethimi;
- Punime për kullimin e ujërave atmosferike;

Raport Teknik i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis

- Punime për zonat e gjelbëruara;
- Punime për ujitjen e zonave të gjelberuara;
- Pastrim i të gjitha mbetjeve dhe objekteve të ndërtimit dhe krijimi i një peizazhi të këndshëm e të pastër.

dh) informacion për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve (si dhe informacion për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja)

1.Furnizimi me energji elektrike;

2.Furnizimi me ujë;

3.Shkarkimi i ujërave të shiut.

e) Programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikimit për funksionimin e projektit, kohën e mundshme të përfundimit të (si dhe informacion për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja).

Përsa i përket shtrirjes kohore, ndikimi i projektit për ndërtimin e projektit do të jetë tejet i kufizuar. Sikurse është theksuar në seksionet e mësipërme, ku janë marrë në konsideratë të gjithë elementët mjedisorë që mund të preken nga projekti, ndikimi në zonën ku zhvillohet, pritet të jetë minimal.

Kohëzgjatja e punimeve do të jetë që nga dita e marrjes së lejes së ndërtimit.

Ndikimet e fazës ndërtimore do të zgjasin për aq kohë sa zgjasin punimet për ndërtimin. Me përfundimin e fazës së ndërtimit do të merren masa për rehabilitimin e zonës së punimeve. Zonat e gjelbra do të ruhen gjatë ndërtimit, por edhe ajo pjesë që do të demtohen do të zëvendësohet me drurë e pemë të tjera dhe sipërfaqe të gjelbëruara. Përsa i përket ndikimeve gjatë fazës së funksionimit ato do të jenë prezente për aq kohë sa do të përdoren edhe ndërtesat. Këto ndikime nuk janë me rëndësi të vecantë. Ndikimi në peizazh do të jetë i përkohshëm për fazën e ndërtimit.

ë) Lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyrën e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji).

Për ndërtimin e objektit do të përdoret material si; Rërë, Zhavor, Asfalt, Stabilizant, Beton, Hekur, Tuba PE100, Tuba të brinjëzuar, Tulla, Konstruksiione metalike, Rakorderi HDPE, bronxi, matës uji ,Hidrantë etj

f) Informacion për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese (përreth/pranë zonës së projektit);

Ky projekt ka mundësi të lidhet me projekt tjetër në zonë, pas përfundimit të mbylljes së kanalit ekzistues të KUL, në vijëmsi parku linear mund të vazhdoje të ndërtohet përgjatë kanalit të mbyllur.

g) Informacion për alternativat e marra në konsideratë për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret

Vendi në të cilën do të zhvillohet aktiviteti i përket Bashkisë Durrës. Zona në të cilën do të zbatohet projekti objekti është tokë truall.Përgjatë parkut godina banimi në të dyja anët e parkut. Zona ku do të kryhet investimi ndodhet në veri-perëndim të qytetit dhe përfshin lagjen 8 dhe 15, zona Spitallë. Kjo zonë e cila

Raport Teknik i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis

karakterizohet nga rritja e numrit të popullsisë si rezultat i ndryshimeve demografike që ka pësuar në periudhën e pas viteve 90-të. Popullsia llogaritet 168,000 banorë. Pozicionohet në pjesën kodrinore të qytetit, që përfshin aksin rrugor dhe hapësirat publike rreth nga rruga “Pjetër Bogdani” deri në rrugën “Syri i Detit” në zonen e Spitalës në qytetin e Durrësit. Sipërfaqja që do të zihet nga ky rikualifikim urban është 10 000 m² park urban dhe 20 000 m² sipërfaqe rruge.

Parku do të ndërtohet mbi kanalin e mbyllur të KUL.

Në gjëndjen ekzistuese rruga automobilistike nuk është e asfaltuar, mungojnë korsitë e biçikletave, hapësirat për lëvizjen dhe qëndrimin e kalimtarëve, hapësirat rekreative për grupmosha të ndryshme dhe një gjelbërim i sistemuar. Teknologjia që do të përdoret është bashkohore dhe me standarte të larta të materialeve të ndërtimit.

gj) Të dhëna për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, (përfshirë sasi të ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe për mënyrën e sigurimit të tyre).

Gjatë përdorimit të aktivitetit do të përdoret uji për ujitjen e parkut i cili do të merret nga rezervuari i Spitalës. Do të përdoret ujë për çezmat publike dhe Hidrantët për mbrojtjen ndaj zjarrit, prurja e të cileve është menduar të merret nga rrjeti i ujësjellësit në këtë zonë. Do të përdoret energji elektrike nga rrjeti për ndriçimin e parkut.

h) Të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, (sindërtimi i kampeve apo rezidencave etj).

Do të ndërtohet kantjeri i objektit që do të ndërtohet një ndërtesë e vogël (konternier) për personelin kryesor dhe mbajtjen e materialeve.

i) Të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, (si sindërtimi i kampeve apo rezidencave etj.)

Në funksion të instalimeve dhe materialeve ndërtimore, do të ndërdohet kabina e rojeve. Aktivitete të tjerë të mundshëm janë ato të transportit, të lëndës së parë dhe largimi i manureve dhe mbetjeve të tjera, të cilat do të kryhen nga kontraktorët përkatës.

j) Informacion për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, (si dhe institucionet kompetente për lejimin/ autorizimin/ licencimin e projektit).

Per zhvillimin e projektit per ndërtimin e godinës, subjekti duhet te pajiset me lejet dhe licencat e meposhtme:

- Leja e Ndertimit te objektit dhe autorizimet nga Ujesjelles – Kanalizime, PMNZSH, OSSHE, Albtelekom nga KKT
- Firma e ndertimit disponon mjete te licensuara per transport te mbetjeve. Gjithashtu firma e ndertimit do te lidhi kontrate dhe me Bashkine per vendepozitim e mbetjeve.

Projekti mund të mos ketë transport të mbetjeve inerte (nga gërmimet) por megjithatë si detyrim i Ligjit 10463 datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar, Investitori do të operojë për të gjitha makineritë, që do të jenë të pajisur me licensë të tipit III.2.B si detyrim i këtij ligji.



Ilustrim 3-Dimensional i objektit

Baza ligjore:

Sipas VKM Nr. 686, datë: 29.7.2015, “ Për miratimin e rregullave, të përgjegjëse e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore” Ligji Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440”, datë 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”.

Klasifikimi:

Sipas Shtojcës II të ligjit 10440 “Projektet që i nënshtrohen procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis/ **Pika 10.** Prodhime infrastrukturore
b) Projekte për zhvillime urbane, duke përfshirë dhe ndërtimin e qendrave tregtare dhe parkimet për makina”.**Pika 12.** Turizmi dhe koha e lire, d) Parqe tematike

**Raporti i VNM-së u hartua:
“HYDRO-ENG CONSULTING”
shpk**

Administrator :Z.Evis QYRKU
Ekspert Mjedisë;Z.Shpëtim ÇIKU
(Nr.lic,A.2443, Nr5077 Prot, Datë
08.07.2013)

RAPORT PARAPRAK I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

“Sudim Projektim Parku Urban -Spitallë”

Zhvillues: Bashkia Durrës,

Projektues: “BOE“IDEAL CONSTRUCTION
AND PROJECTION (I.C.P)” Sh.p.k& “HYDRO-
ENG CONSULTING” sh.p.k, përfaqësuar nga
Shoqëria I.C.P, përfaqësues i autorizuar Z.Alban
DUTAJ

Adresa: Rruga Aleksandër Goga, Lagjja nr. 18, Durrës



PËRMBAJTJE

1.	HYRJE.....	4
2.	KUADRI LIGJOR DHE ADMINISTRATIV.....	8
	2.1 Legjislacioni Kombëtar.....	8
	2.2 Kuadri institucional.....	12
3	INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM-SË DHE METODIKËN E ZBATUAR.....	14
	3.1 Përshkrim të qëllimit dhe objektivave të VNM-së	14
	3.2 Objektivat e raportit të V.N.M.-së.....	15
4	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT.....	17
	4.1 Gjendja Ekzistuese.....	17
	4.2 Statusi i zonës se studiuar dhe objektivi i projektit.....	18
5	TREGUESIT E PROJEKTIT.....	18
6	EKONOMIA E ZONËS DHE AKTIVITETET KRYESORE TË SAJ.....	18
	6.1 Statusi i zonës në studim.....	18
	6.2 Mendimi i Komunitetit.....	18
7	PËRSHKRIMI I MJEDISIT TË ZONËS SË PROJEKTIT.....	18
	7.1 Një përshkrim i shkurtër i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të Zbatohet.....	18
	7.2 projekti, (i shoqëruar dhe me imazhe).....	18
	7.3. Informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të saj.....	27
8	IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS NGA ZBATIOMI I PROJEKTIT.....	31
9	ANALIZA E GJËNDJES EKZISTUESE DHE VLERËSIMI I SITUATËS	36
	9.1 Ndikimet në mjedis gjatë ndërtimit.....	36
	9.2 Ndikimet në mjedis gjatë largimit të materialeve nga kanalet, ndërtimi i rrugëve, shkallareve etj.....	36
	9.3 Ndikimet në mjedis si rezultat i sjelljes së materialeve të ndryshme.....	36
	9.4 Vlerësimi i efektivitetit të pritshëm të masave zbutëse.....	36
	9.5 Zhurmat.....	36
	9.6 Ndikimet në ujrat sipërfaqësore.....	36
	9.7 Ndikimet në ujrat nëntokësore.....	36
10	PLANI I ZBUTJES SË NDIKIMEVE NEGATIVE DHE REHABILITIMET.....	37
	10.1 Përdorimi tokës.....	37
	10.2. Ndikimet në peisazh.....	38
	10.3 Ndikimet e rrjetit mbi trashgimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe vepra të tjera njerëzore.....	38
	10.4 Ulja e intensitetit të erozionit dhe zbutja e ndryshimeve të topografisë...38	
11.	NDIKIMET NË FLORË, FAUNE DHE GJEOLGJINË.....	38
	11.1 Flora dhe Fauna.....	38
	11.2 Humbja dhe dëmtimi i tipareve gjologjike, paleontologjike, problemi	

i mjedisit Gjeologjik.....	39
12. NDIKIMET E PRITSHME NË MJEDISIN PËRRETH.....	39
12.1 Ndikimet fizike të projektit në ndryshimet e topografisë së zonës, tokës, etj.....	39
12.2 Në cilësinë dhe sasinë e tokës.....	39
12.3 Ndikimet në ujë.....	39
12.4 Ndikimet e ndotësve dhe mbetjeve në cilësinë e ujit.....	39
12.5 Ndikimet në ajër.....	39
12.6 Ndikimi në klimë.....	40
12.7 Aromat sulmuese.....	40
12.8 Ndikime të tjera klimatike.....	40
12.9 Ndikime të tjera indirekte dhe sekondare, që shoqërojnë projektin.....	40
12.10 Ndikimet shoqëruese të projektit me projekte të tjera ekzistuese ose të propozuara.....	40
12.11 Ndikimi tek njerëzit, ndërtesat dhe objektet e ndërtuara nga njeriu.....	41
13. MASAT PËR ZBUTJEN E NDIKIMEVE NË MJEDIS GJATË ZBATIMIT TË PROJEKTIT.....	42
13.1 Organizimi.....	42
13.2 Masat e sigurimit teknik në punë.....	42
13.3 Mbrojtja e mjedisit.....	43
13.4 Masat e mara për zbutjen e rrezikut në mjedis dhe shëndet.....	44
14. MATRICAT PËRMBLEDHËSE TË NDIKIMEVE NË MJEDIS.....	44
14.1 Matrica e ndikimeve në mjedis.....	44
14.2 Matrica e prioriteteve të ndikimeve në mjedis gjatë fazes së ndërtimit dhe Shfrytëzimit.....	46
14.3 Matrica e prioriteteve të ndikimeve në mjedis gjatë fazes së ndërtimit.....	46
14.4 Matrica e prioriteteve të ndikimeve në mjedis gjatë fazes së shfrytëzimit.....	47
15. ASPEKTET NEGATIVE DHE POZITIVE TË NDIKIMIT NË MJEDIS.....	47
15.1 Efektet negative.....	47
15.2 Efektet positive.....	47
16. PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS TË PROJEKTIT.....	48
16.1 Plani i monitorimit.....	48
16.2 Efektet potencialet ndotëse të mjedisit dhe masat mbrojtëse gjatë fazes së ndërtimit dhe gjatë fazes së shfrytëzimit.....	49
17. INVESTIMET E PARASHIKUARA.....	49
18. MASAT PËR RIGJENERIMIN E SIPËRFAQES GJATË NDËRTIMIT DHE SHFRYTËZIMIT.....	49
19. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....	50

I. HYRJE

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis bazohet në rëndësinë e hartimit të një studimi me standarte bashkëkohore, duke pasur parasysh pasuritë natyrore dhe njerëzore të zonës në shqyrtim, vlerat e veçanta të tyre, si dhe kërkesat e banorëve të zonës. VNM-ja zbulon, përshkruan dhe vlerëson ashtu sic duhet dhe për çdo rast në veçanti, pasojat e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të një projekti.

Ky raport do të hartohet për projektin “Sudim Projektim Parku Urban -Spitallë”, me kërkesë të shoqërisë BOE“IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION (I.C.P)” Sh.p.k me NIPT L91310511L & “HYDRO-ENG CONSULTING ” Sh.p.k me NIPT M11417503F, përfaqësuar nga shoqëria I.C.P Shpk, në rolin e projektuesit të projektit, me seli në Durrës, Rruga Aleksandër Goga, Lagjja nr. 18, Durrës.

TË DHËNAT KRYESORE TË PROJEKTIT

Zhvillues: Bashkia Durrës

Projektues: BOE“IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION (I.C.P)” Sh.p.k me NIPT L91310511L & “HYDRO-ENG CONSULTING ” Sh.p.k me NIPT M11417503F, përfaqësuar nga shoqëria “IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION (I.C.P)” Sh.p.k.

Objekti: “Sudim Projektim Parku Urban -Spitallë”

Vendodhja: Spitallë, Bashkia Durrës

TREGUESIT E ZHVILLIMIT

Sipërfaqja e pronës që zhvillohet 16000 m²

Sipërfaqja e gjurmës së objektit 16000 m²

Zona ku do të kryhet investimi ndodhet në veri-perëndim të qytetit dhe përfshin lagjen 8 dhe 15, zona Spitallë. Kjo zonë e cila karakterizohet nga rritja e numrit të popullsisë si rezultat i ndryshimeve demografike që ka pësuar në periudhën e pas viteve 90-të. Popullsia llogaritet 168,000 banorë. Pozicionohet në pjesën kodrinore të qytetit, që përfshin aksin rrugor dhe hapësirat publike rreth nga rruga “Pjetër Bogdani” deri në rrugën “Syri i Detit” në zonen e Spitallës në qytetin e Durrësit. Sipërfaqja që do të zihet nga ky rikualifikim urban është 10 000 m² park urban dhe 20 000 m² sipërfaqe rruge.

Në vitet 2019-2020 Bashkia Durrës ka realizuar investimin me objekt “Rehabilitim i Kanalit KUL, faza II dhe faza III”, i cili ka realizuar ndërtimin e kanalit të mbyllur me strukturë beton – arme. Mbulimi i këtij kanali është zgjedhur si alternativa më e mirë që do të shërbejë si rrugë lidhëse me rrugën kryesore “A.Goga”.

Gjithashtu aktualisht Bashkia Durrës po zbaton investimin me objekt “Rehabilitimi i Infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto-Romanos - Kënetë dhe sistemimi i rrjetit të ujrave të shiut në zonën urbane të Qytetit të Durrësit, Faza I”.

Të dyja këto investime kanë lidhje me të njëjtin kanal i cili është mbyllur për një gjatësi prej 1.08 km ku kërkohet të zhvillohet dhe projekti në fjalë për Parkun Urban Spitallë.

Nga këto dy investime janë përfituar 1.08 km gjatësi hapësirë publike, dhe me qëllim shfrytëzimin maksimal të kësaj hapësire, kërkohet të realizohet një zonë rekreative, me krijimin e hapësirave të

gjelbëruara mbi të me mbjelljen e pemëve, vendosja e disa stolave për pushim, krijimin e disa parqeve me kënde lojërash për fëmijë, etj.



Pozicionimi gjeografik i sheshit të ndërtimit.

Rajoni i Shqipërisë Perëndimore, ku bën pjesë qyteti i Durrësit, është ndër hapësirat më të rëndësishme të banimit, zhvillimit ekonomik, kulturor dhe turistik të Shqipërisë. Qyteti i Durrësit është një nga portat kryesore të hyrjes së mallrave dhe turistëve nëpërmjet portit të Durrësit. Gjithashtu për shkak të distancës së afërt me kryeqytetin e gjithë zona përreth autostradës Durrës – Tiranë është e zhvilluar si zonë industriale me biznese të natyrave të ndryshme.

Shqipëria është palë e një numri Konventash Ndërkombëtare (Barcelona, Ramsari, Konventa e Biodiversitetit, etj), dhe tashme ka një paketë të plotë ligjore për masat mbrojtëse të mjedisit dhe vlerësimin e impaktit ambjental të veprimtarive, shërbimeve apo ndërtimeve në mjedisin veprues.

Ky kuader ligjor dhe angazhimet ndërkombëtare në fushën e mjedisit, shtrojnë shumë detyra ndaj institucioneve për të zbatuar një sistem sa më efektiv për administrimin e ujrave, jo vetëm në drejtim të zgjidhjes së problemit për shfrytëzimin e ujit për furnizimin e popullsisë me ujë të pijshëm, por dhe zbatimit të përgjegjësive të rrjedhura nga këto marrëveshje. Vendi ynë duke qenë anetar i një numri konventash,

detyrohet të zbatojë një sistem sa me efektiv ekonomik dhe social-mjedisor, për rregullimin e territorit, sidomos në funksion të zgjidhjes së problemeve të ndryshme mjedisore.

Në zhvillimin ekonomiko-shoqëror të një vendi, gjithnjë në përputhje me parimin universal të zhvillimit të qëndrueshmë, marrin rëndësi të veçantë gjetja e rrugëve dhe teknologjive më efikase, si për shfrytëzimin sa më racional të pasurive natyrore, ashtu edhe për kontrollin cilësor dhe sasior të ndikimit mbi mjedis, dhe sidomos në burimet nënujore.

Shkarkimet e lëngeta urbane dhe industriale në ujrat sipërfaqësore janë tashmë një dukuri e rëndomtë, të cilat në mënyrë progresive kanë ndikuar në dëmtimin e cilësisë së ujrave të lumejve tanë. Këto ndikime, shpesh herë të njohura por edhe të panjohura, janë më të dukshme në impaktin që kanë në shëndetin e njeriut dhe në mjedisin në përgjithësi.

Shfrytëzimi i baseneve ujëmbajtës ka çuar në disa raste në prishjen e ekuilibrave natyrore, për shkak të një shfrytëzimi pa kriter dhe pa rregulla sipas një ligjshmërie të caktuar shkencore. Shfrytëzimi i baseneve ujore është ndërhyrje tepër e rëndësishme në aktivitetin e tij normal. Për këtë qëllim ndërhyrja, me synim kullimin e ujrave sipërfaqësor duhet koordinuar me aktivitete të tjera jetësore dhe ekonomike të zonës. Vëmendje e veçante duhet të kihet sidomos:

- kur këto basenë janë afër qëndrave të banuara,
- kur ka toka që përdoren për bujqësi
- kur nga këto basene furnizohet me ujë të pijshëm popullsia,
- kur ka objekte industriale që janë të lidhur me nevojat për ujë teknologjik,
- kur zhvillohen aktivitete të akuakulturës,
- kur janë zona që kanë një status të veçantë, etj.

Prishja e këtyre ekuilibrave vjen si pasojë e një shfrytëzimi pa kriter të këtyre baseneve. Duhet të theksojmë së basenet ujëmbajtëse që nuk prishin këto kërkesa dhe që kanë rezerva të shumta të një cilësie shumë të lartë ka pak në vendin tone.

Në Ligjin me Nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” (V.N.M.) është dhënë në mënyrë të qartë se cilat projekte i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis të cilat klasifikohen si më poshtë:

1. Proçesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis (V.N.M) i nënshtrohen gjithë projektet e veprimtaritë, që jepen në shtojcat 1 dhe 2 të këtij ligji, para miratimit tyre nga organet përkatëse.

2. Projektet e veprimtaritë i nënshtrohen dy niveleve të shqyrtimit për vlerësim ndikimi:

a) Proçesit të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis nënshtrohen projektet e shtojcës 1 dhe projektet e veprimtarisë që kërkojnë të zbatohen në një zonë të mbrojtur.

b) Proçesit të përmbledhur të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM), të cilit i nënshtrohen projektet e shtojcës 2 dhe ndryshimet ose rikonstruksionet e projekteve të shtojcës 1.

TAB 1. KLASIFIKIMI I RAPORTIT TË V.N.M-SË PËR PROJEKTIN “STUDIM PROJEKTIM PARKU URBAN – SPITALLË” BASHKIA DURRËS

Pyetje që duhen marrë parasysh për klasifikimin gjatë zbatimit të projekt-idese apo ushtrimit të veprimtarisë:	Përshkruaj shkurtimisht Po / Jo	Do të ketë ndërveprim / ndikim të rëndësishëm? Po / Jo - Përse?
1. Do të shkaktohen ndryshime fizike në territor (në topografinë, përdorimin e tokës ose burimet ujore etj.)?	Po	Po (do të shkaktohen ndikime fizike të papërfillshme në territorin ku do të ndërtohen kanalet për kullimin e ujërave të shiut, për vaditjen e parkut)
2. Do të përdoren burimet natyrore si: toka, uji, materiale ose energji, veçanërisht ato burime që nuk janë të rinovueshme ose me pakicë?	Po	Po (toka për ndërtimin e kanaleve dhe për rrugën për akses makinash për hyrjet përgjatëzonës ku do të zhvillohet parku , ndërtim korsine e biçikletave)
3. Parashikohet përdorimi, magazinimi, transporti apo prodhimi i substancave ose materialeve të dëmshme për shëndetin dhe mjedisin?	Jo	Jo (materiale të jenë inerte për kanalin dhe godinën të çertifikuar sipas CE).
4. Do të prodhohen mbetje të ngurta?	Po (gjatë ndërtimit të kanaleve)	Jo (mbetjet do të trajtohen në përputhje me VKM 575, datë 24.06.2015 në vendin e miratuar nga njësi vendore)
5. Do të ketë shkarkime në ajër të ndotësve, substancave të rrezikshme, toksike ose helmuese?	Jo	Jo (nuk pritet të ketë shkarkime toksike dhe helmuese nga projekti)
6. Do të ketë zhurma e vibrime apo çlirime drite, energjie ose rrezatim elektromagnetik?	Po (zhurma - gjatë ndërtimit)	Po (do të punohet me orar të kufizuar 7 ⁰⁰ -15 ⁰⁰ për të ulur ndikimin)
7. Do të ketë rrezik për ndotjen e tokës e ujërave nga shkarkimi i ndotësve në sipërfaqen e tokës, ujërave sipërfaqësore, nëntokësore, bregdetare ose në det?	Po	Po (punimet janë sipërfaqësore dhe do të kryhen me kujdes për të mos prishur strukturën e tokës).
8. Ka rrezik për aksidente që ndikojnë në shëndetin e njerëzve apo në mjedis?	Po (gjatë ndërtimit të kanaleve, rrugëve)	Jo (do të zbatohen me rigorozitet kushtet dhe rregullat e sigurimit teknik në punë)
9. Do ketë ndikime sociale, demografike, mënyra tradicionale jetesë, punësim etj?	Po	Po (Projekti do të zhvillohet në zonën ku është ndërtuar kanali për kullimin e ujërave të ndotura edhe të shiut , pritet që parku do të ketë ndikim pozitiv social demografik, rritjen e cilësisë së jetesës si edhe mundësi punësimi për zonën përreth).
10. Ka faktorë të tjerë që duhen marrë në konsideratë si zhvillime që çojnë në pasoja mjedisore apo mundësi për mbivendosje ndikimesh të ndryshme nga veprimtari ekzistuese ose të planifikuara në zonë?	Jo	Jo (Gjatë zhvillimit të projektit janë marrë në konsideratë të gjitha zhvillimet dhe projektet e prashikuara në të ardhmen nga Ujësjellës Kanalizime Durrës Sha dhe OSHE në këtë zonë)
11. Ka zona të mbrojtura nga legjislatiioni ndërkombëtar/kombëtar për vlerat e tyre në biodiversitet, ekologji, peizazh, vlera kulturore, historike e arkeologjike?	Jo	Jo (projekti do të kalojë në gjurmë ekzistuese sipër kanalit të mbuluar të KUL gjatë të cilit nuk është dokumentuar asnjë zbulim arkeologjik)
12. Ka zona të ndjeshme mjedisore, si zona bregdetare, male, pyje, kullota, flore, faun e eger, dru frutore ne zonë?	Jo	Jo (projekti zhvillohet në gjurmë ekzistuese dhe aktualisht në zonën ku do të zhvillohet projekti nuk ka zona të ndjeshme mjedisore)
13. Ka zona me specie të mbrojtura, të rëndësishme ose të ndjeshme, rrezikuara kërcënuara, në rrezik zhdukje të faunës e florës, p.sh. për kryqezime, folenizime, pushime, dimërime, migrime etj. në zonë?	Jo (nuk përfshihet në listën e botuar nga MM)	Jo (rikonstruksioni nuk cënon florën dhe faunën)
14. Ka zona me ujëra tokësore, nëntokesore apo detare në zonë?	PO (Rezervuar)	Jo (ndikim të papërfillshëm pasi shkarkimet do të behën në kanalin e KUL i cili nuk ka ndikim tek rezervuarët)

15. Ka zona me tipare të spikatura panoramike ose skenike në zonë?	Jo	Jo (Ndërtimi i parkut nuk prek zona të spikatura panoramike)
16. Ka rrugë a infrastruktura të ngjashme që përdoren nga publiku për të shkuar në vende pushimi etj. ose rrugë transporti të mbingarkuara që mund të ndikohen?	Po (Rruga ekzistuese)	Jo (ka ndikim në lëvizjen e mjeteve dhe njerëzve gjatë ndërtimit)
17. Ka përdorime ekzistuese të tokës (banine, industri, tregti, pushim, bujqësi, pyje, turizëm, zona të gjelbra, sportive, argëtuese, prona të tjera private etj.) ose plane të ardhshme që ndikohen?	Po (rrugë, zona të banuara, varreza)	Jo (kanalet janë në gjurmë ekzistuese)
18. Është zona nën rrezikun e ndotjes ose dëmtimeve mjedisore (ku standartet mjedisore janë tejkalluar)?	Jo	Jo
19. Është zona me probleme sa i përket tërmetejeve, rrëshqitjes dherave, erozionit, përmytjeve, kushteve ekstreme klimatike (ndryshime të temperaturës, mjegulla erëra të forta)?	Po (Termeti, Rreshqitja)	Jo (projekti nuk ka ndikime të ndjeshme pasi në pjesën më të madhe shtrihet në kanal ekzistues.)

2. KUADRI LIGJOR DHE ADMINISTRATIV

Përshkrim të përmbledhur të kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin;

2.1 Legjislacioni Kombëtar

Kuadri ligjor për Mbrojtjen e Mjedisit në Republikën e Shqipërisë është në përputhje me standartet e BE-së. Kuadri për VNM-në sigurohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga dy ligje për mjedisin në Shqipëri.

Në mënyrë të veçantë, ligjet e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor (VNM) janë zhvilluar dhe kanë hyrë në fuqi gjatë dekadës së fundit.

Ligji mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) përcakton tipin dhe shkallën e projekteve apo veprimtarive që kërkojnë VNM para implementimit. Kategoritë e VNM-ve janë:

VNM Paraprake dhe VNM e Thelluar.

Aktiviteti në vlerësim, në bazë të klasifikimit të tij si aktivitet me ndikim të vogël në mjedis, klasifikohet si raport paraprak i VNM.

Legjislacioni mjedisor është hartuar për të mbrojtur dhe parandaluar komponentë të vecantë dhe të rëndësishëm të mjedisit. Kështu, ndër ligjet me specifike që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me projektin në vlerësim, mund të përmendim:

Në ligjin Nr. 10 431, datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" theksohet në kapitullin V (VNM) neni 25 se: Vlerësimi i ndikimit në mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjesë e përgatitjeve për planifikimin e një projekti zhvillimi dhe para kërimit të lejeve përkatëse të zhvillimit.

Në Ligjin Nr.10 440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" në kreun II, neni 7 për "Proçedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis" thuhet: Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, bashkelidhur këtij ligji, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës për zhvillimin ose jo të projektit.

Proçedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

- proçesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;

- procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Dokumenti bazë ku mbështetet procesi i VNM-së dhe liçencimi, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit, mund të jetë:

- raporti paraprak i VNM-së për projektet e shtojcës II;

- raporti i thelluar i VNM-së për projektet e shtojcës I.

Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin indentifikimin, saktësimin dhe vlerësimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të projektit në mjedisin ku do të zbatohet, si dhe përcaktimi i masave për të parandaluar dhe zbutur dëmtimet në mjedis që në fazën fillestare të tij. Ky aktivitet, në bazë të klasifikimit të tij që bën pjesë në aneksin 2 te ligjit për Vlerësimin e

Ndikimit në Mjedis, klasifikohet si VNM paraprake. Legjislacioni mjedisor është hartuar për të mbrojtur dhe parandaluar komponentë të veçantë dhe të rëndësishëm të mjedisit.

Ky raport hartohet mbi bazën e mbrojtjes së mjedisit dhe në funksion të institucioneve vendimmarrëse për liçensimin ose jo të aktiviteteve të ndryshme.

Me mbrojtje të mjedisit do të kuptojmë veprimtaritë të cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet bazë të mbrojtjes së mjedisit të cilat janë:

- 1.Parimet e mbrojtjes së mjedisit
- 2.Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- 3.Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- 4.Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- 5.Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- 6.Parimi i qasjes së integruar
- 7.Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- 8.Parimi "Ndotësi pagan"
- 9.Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- 10.Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit nënkupton mbrojtjen e integruar të përbërësve të mjedisit nga ndotja, si veçmas, ashtu dhe në kombinim, duke pasur parasysh ndërveprimet ndërmjet tyre dhe qysh në fazën e planifikimit të zhvillimit të një territori të caktuar. Mbrojtja e Përbërësve të mjedisit klasifikohet në:

- Mbrojtja e ajrit
- Mbrojtja e ujërave
- Mbrojtja e tokës
- Mbrojtja e natyrës
- Ndryshimet klimatike

Përmbledhje e kuadrit ligjor

Legjislacioni mjedisor është ndërtuar për të mbrojtur dhe parandaluar komponentë të veçantë dhe të rëndësishëm të mjedisit. Kështu, ndër më specifiket mund të përmëndim:

- Ligji nr 10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar.
- Ligji nr 10440 datë 07.07.2011: Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar.
- Ligji nr 10448 datë 17.07.2011 “Për lejet e mjedist”, i ndryshuar.
- Ligj nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”.
- Ligji nr 9774 datë 12.07.2007 “Vlerësimin dhe administrimin e zhurmave në mjedis”
- VKM Nr. 587 datë 07.07. 2010 Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike
- Udhëzimi Nr.8 datë 27.11.2007 Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara
- Udhëzim Nr.1, datë 19.02.2018 Për miratimin e kërkesave minimale për hartimin e planeve të veprimt për zhurmat
- Ligji nr 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve “
- Ligji nr 1189 datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe proceduart për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”
- Kuventa e AARHUS “Për të drejtat e publikut për informim mjedisor, pjesmarrjen e publikut në vendimarrje dhe për tu drejtuar gjykatës për çështje mjedisore “
- Ligji Nr.10 081, datë 23.02.2009 "Për Liçencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- VKM Nr. 686, datë 29.07.2015,”Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisve e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”.
- VKM nr 24 datë 22.01.2014 “Për veprimtarinë e inspektoriatit të mjedisit “
- VKM nr 103 datë 31.03.2002 “Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë
- Ligji nr 8906 datë 06.06.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotia dhe dëmtimi”
- Ligji nr 7875 datë 23.11.1994 “Për mbrojtjene faunës së egër dhe gjuentinë “
- Ligji nr 7623 datë 13.10.1992 “Për pyjet dhe policinë e shërbimit pyjor “
- Ligji nr 8672 datë 26.10.2000 “Për ratifikimin e Kuventës së Arhusit “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimarrje dhe për tu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit “
- VKM nr 16 datë 04.01.2012 “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor
- Ligji nr 9334 datë 16.12.2004 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Kiotos të Kunventës ne kuadër të Kombeve të Bashkuara për ndryshimet Klimatike “

- VKM nr 1553 datë 26.11.2008 “Krijimin e Autoritetit Kombëtar të Përcaktuar të mekanizmit të zhvillimit të pastër, në kuadër të zbatimit të angazhimeve të Protokollit të Kiotos”
- Ligji nr 91/2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor”
- VKM nr 597 datë 01.07.2015 “Për përcaktimin e rregullave e procedurave dhe kërkesave të hollësishme për lidhjen e marveshjeve vullnetare, nëpërmjet organizatave dhe grupeve që përfaqsojnë interesa të caktuara, grupeve të operatorëve ose operatorëve individual me autoritetet përkatëse për realizimin e një niveli më të lartë mbrojtjeje sesa ai I përcaktuar në legjislacionin e posacëm për një përbërës mjedisor.
- VKM nr 219 datë 11.03.2015 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për konsultimin me grupet e interes dhe publikun, si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimit Strategjik Mjedisor”
- VKM nr 620 datë 07.07.2015 “Për miratimin e rregullave, përgjegjësi dhe procedurave të detajuara në vlerësimin strategjik në mjedis në kontekstin ndërkuftar”
- VKM nr 507 datë 10.06.2015 “Për miratimin e listës së detajuar të planeve apo programeve me pasojë negative në mjedis, që do të nënshtrohen procesit të vlerësimit Strategjik Mjedisor”
- VKM nr 575 datë 24.06.2015 “ Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte“
- VKM nr 765 datë 07.11.2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorur”
- “VKM NR 226 datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit qe duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit“
- VKM nr 371 datë 11.06.2014 “ Për miratimin e rregullave për dorzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të domkumentit të dorzimit të tyre”
- VKM nr 418 datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim“
- Në parlamentin Shqiptar janë miratuar edhe disa ligje në kuadër të përfshirjes së vendit tonë në Protokolle dhe marreveshje të ndryshme. Ndër to përmendim:
- Ligji Nr. 9672 datë 26.10.2000: "Për ratifikimin e konventës së Aarhusit" Për të drejtën e publikut për të pasur informacion dhe përfshirjen në vendimarrje, si dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit.
- Ligji Nr. 9334 datë 16.12.2004: "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Kiotos" në konventën për ndryshimet klimatike (UNFCCC).
- Ligji Nr. 9424 datë 06.10.2005: "Për ratifikimin e protokollit të vlerësimit strategjik mjedisor".
- Ligji Nr. 9486 datë 06.03.2006: "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Amendamentin e Pekinit për protokollin e Montrealit" Për substancat që hollojnë shtresën e Ozonit.

- Ligji Nr. 9548 datë 01.06.2006: "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin për regjistrat e shkarkimit dhe transferimit të ndotësve"
Si dhe:
- Ligji nr. 10463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" të ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr 798, datë 29. 09. 2010. "Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 229, datë 23. 04. 2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 418, datë 25.06.2014" Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim"
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 18.2.2005, të këshillit të ministrave, "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve" të ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 687, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 371, date 11.06.2014 "Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme";

2.2 Kuadri institucional

Institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit

Një pjesë e madhe e legjislacionit , përfshirë ligjin mbi mbrojtjen e mjedisit është përshtatur tashmë , për të ndihmuar në arritjen e këtyre objektivave . Institucionet janë organizuar ose po organizohen për të monitoruar dhe zbatuar ligjet , por ka ende një punë të gjatë për të bërë , drejt arritjes së qëndrueshmërisë. Institucioni kryesor dhe më i rëndësishëm në fushën e mjedisit është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Në varësi të kësaj Ministrie janë edhe Agjencia Kombetare e Mjedisit, Drejtoritë Rajonale të Mjedisit, si dhe Drejtorite Rajonale të Menaxhimit të Pyjeve. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është e përbërë nga 12 Drejtori Rajonale të Mjedisit të cilat ushtrojnë funksion lokal në rang prefekturë dhe Agjencia Kombetare e Mjedisit e cila ka funksion kombëtar.

Institucione të tjera përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit janë edhe Pushteti vendor, si dhe Ministri të tjera si ajo e Transporteve, e Bujqësisë, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, etj, sipas fushës së veprimtarisë. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) është autoriteti kryesor përgjegjës për menaxhimin dhe mbrojtjen e mjedisit dhe hartimin e politikave mjedisore në nivel kombëtar. Ministria e Mjedisit u krijua si organi shtetëror i specializuar për mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri. Ajo harton dhe zbaton politikën e qeverisë për mbrojtjen e mjedisit, harton projekt-akte ligjore e nën-ligjore në fuksion të

mbrojtjes dhe menaxhimit të qëndrueshëm të mjedisit, bashkërendon aktivitetet e institucioneve të linjës për çështje të mjedisit, organizon dhe koordinon punën për monitorimin e mjedisit, përgatit projekt-marreveshjet ndërkombetare apo bilaterale për mbrojtjen e mjedisit, përgatit Raportin vjetor "Per Gjendjen e Mjedisit", shqyrton dhe jep aktet e miratimit të lejeve mjedisore për aktivitetet e ndryshme ekonomike, etj. Në bazë të ligjit për mbrojtjen e mjedisit, neni 67, përgjegjësitë kryesore të MTM janë: Si institucion qendror i specializuar për mbrojtjen e mjedisit dhe si mbështetëse teknike e Ministrisë, Ministria kryen edhe këto detyra kryesore:

Bashkëpunon me institucionet qendrore, me organet e qeverisjes vendore, me publikun dhe organizatat jofitimprurëse mjedisore e profesionale, për të rritur shkallën e zbatimit të legjislacionit mjedisor;

Përgatit projektet e marrëveshjeve, të protokolleve e programeve të bashkëpunimit dy e shumëpalësh, me shtete, organe dhe organizata ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit dhe ndjek zbatimin e tyre;

Studion nevojat e vendit për specialistë për mbrojtjen e mjedisit dhe bashkërendon me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për kualifikimin e specializimin e tyre;

Mbështet projekte për punë kërkimore-shkencore, për përmirësimin e gjendjes së mjedisit, për futjen e teknologjive ekologjikisht të pastra, për nxitjen e veprimtarive të organizatave jofitimprurëse mjedisore;

Ndihmon organet e qeverisjes vendore për mbrojtjen e mjedisit dhe për hartimin e zbatimin e planeve vendore për mjedisin.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)

Në ligjin për mbrojtjen e mjedisit, Nr. 10431, datë 09.06.2011, në Nenin 59 "Organizimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" përcaktohet:

- Agjencia Kombëtare e Mjedisit është institucion qendror publik në varësi të ministrit, që ushtron juridiksionin e vet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, përmes zyrës qendrore dhe degëve rajonale në qarqe, të cilave këtu e më poshtë do t'u referohemi si agjencitë rajonale të mjedisit.
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit financohet nga Buxheti i Shtetit dhe burimet e veta.
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka pavarësi në vendimmarrjen dhe kryerjen e funksioneve të saj, të parashikuara në këtë ligj. Këshilli i Ministrave, në përputhje me kërkesat e këtij ligji, miraton rregulla të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe të agjencive rajonale të mjedisit, ndarjen dhe organizimin e punës, statusin e punonjësve dhe marrëdhëniet e saj me institucione të tjera. Kryeministri, me propozimin e ministrit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, miraton strukturën dhe organikën e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe të agjencive rajonale të mjedisit. Ndërsa në Nenin 60, të këtij ligji përcaktohen funksionet e këtij institucioni.

Agjencisë Kombëtare të Mjedisit:

1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit është autoriteti kompetent për përcaktimin e kushteve për lejet përkatëse të mjedisit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, me legjislacionin për lejet e mjedisit dhe me dispozitat e ligjeve të tjera përkatëse dhe ka këto funksione:

- Hartimin e Programit Kombëtar për Monitorimin e Mjedisit dhe monitorimin e gjendjes së mjedisit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- Përgatitjen dhe publikimin e raporteve vjetore për gjendjen e mjedisit;
- Kryerjen e shërbimeve të matjes së shkarkimeve në mjedis me kërkesë të ministrisë;
- Këshillimin e organeve vendore për zbatimin e politikave mjedisore;
- Krijimin dhe menaxhimin e sistemit të informacionit mjedisor;
- Krijimin dhe menaxhimin e Regjistrit të Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve;
- Sigurimin e informacionit mjedisor për publikun, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- Sigurimin e informacionit për publikun për procesin e vendimmarrjes për çështjet mjedisore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- Sigurimin e zbatimit të parimit të përgjegjësisë mjedisore për çdo operator, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- Menaxhimin e sistemit të të dhënave për pyjet.

2. Kjo agjenci kryen edhe funksione të tjera që i ngarkohen me legjislacion të posaçëm. Në nivel rajonesh veprojnë 4 Agjenci Rajonale të Mjedisit (ARM), të cilat nëpërmjet ndryshimeve ligjore të muajve të fundit, kalon në varësi të AKM. ARM-t i kryejnë funksionet dhe kompetencat brenda territorit të një rajoni të caktuar duke përfshirë të gjitha rrethet dhe komunat e bashkitë e këtyre rajonve.

3. INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM-SË DHE METODIKËN E ZBATUAR

3.1 Përshkrim të qëllimit dhe objektivave të VNM-së;

Raporti Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e objektit në studim është hartuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Qëllimi i këtij raporti është marrja parasysh e faktoreve që ndikojnë në mjedis gjatë ndërtimit të objektit dhe funksionimit të tij. Ky raport është pjesa më e rëndësishme e dokumentacionit të kërkuar, në zbatim të procedurës së nevojshme gjatë procesit të miratimit të lejes mjedisore. Raporti ka gjithashtu si qëllim të japë një vështrim të përgjithshëm mbi efektet në mjedis, alternativat e mundëshme dhe masat zbutëse të efekteve të padëshirueshme.

V.N.M-ja synon parashikimin e të gjithë efekteve të pritshme në mjedis, që do të rezultojnë nga një projekt i propozuar, si gjatë zbatimit ashtu dhe gjatë funksionimit të tij. Raporti përfshin gjithashtu

parashikimin dhe planifikimin e masave zbutëse të ndikimeve të projektit në mjedisin fizik dhe social me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së mjedisit nëpërmjet:

- Marrja në konsideratë e çështjeve të mjedisit në fazën e përgatitjes së propozimeve në projekt.
- Shqyrtimit të alternativave të ndryshme brenda projektit.
- Nxjerrjes në dukje dhe vlerësimit cilësor me pika të ndikimeve në mjedis të projektit.
- Propozime të masave zbutëse të ndikimit në projekt, etj.

Qëllimi i këtij raporti, i përgatitur për rastin e ndërtimit të parkut urban, është që të indentifikojë pasojat e mundshme negative mjedisore që mund të krijohen gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit të hapësirave ku do të ndërtohet parku urban.

Gjithashtu një tjetër synim i këtij raporti është të përcaktojë e të rekomandojë masat tekniko-organizative për zbutjen e faktoreve negativë që ekzistojnë, dhe të atyre që krijohen gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit të tij. Raporti i këtij projekti është hartuar për të integruar mbrotjen ambientale në jetën e përditshme, që të udheheqë në ndryshimin e sjelljes së komunitetit, duke u bërë në këtë mënyrë forca shtytvse e përmirësimit të vazhdueshëm.

Metoda me e përshtateshme për ndikimin është ajo e list kontrollit, e cila vendos nga njëra anë të gjitha burimet e mundshme të ndikimeve dhe nga ana tjetër mbartësit e ndikimeve, si dhe parashikimin e madhësisë së ndikimit.

3.2 Objektivat e raportit të V.N.M.-së

Objektivat raportit konsistojnë në analizimin e faktorëve lokale e negative mjedisore, në dhënien e masave zbutëse për reduktimin e ndikimeve negative, si dhe tenton në përmirësimin e vlerave ekologjike e rikrijuese të territorit gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit.

Qëllimi i është, që nëpërmjet vlerësimit cilësor e sasiar paraprak të parametrave hidrologjike të treguesve gjeologo-inxhinjerike, parametrave sizmo-tektonike, morfologjike e gjeomorfologjike të bazuara në kritere e standarte shkencore ndërkombetare, të tipizohen dhe të përzgjidhen një sërë parametrash dhe veçorish të sistemeve të sipërpërmendur natyrore, në shërbim të infrastrukturës mjedisore, të infrastrukturës urbane si dhe ndërtimit dhe shfrytëzimit të hidrovorit, etj.

Ky raport ka për qëllim të shërbejë:

- Si instrument për mbrotjen e mjedisit;
- Në fuqizimin e komunitetit për veprime në mbrotje të mjedist;
- Të japë informacion për vendimmarrësit për pasojat mjedisore të studimet e propozuara;
- Të promovojë zhvillimin miqësor dhe të qëndrueshëm me mjedisin duke identifikuar masat e duhura për përmirësimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis;
- Reduktimi i ndikimeve në mjedis arrihet nëse një zhvillim bëhet i qëndrueshëm me mjedisin;
- Në mbrotje të pasojave financiare dhe social-ekonomike:

- Në rritje të interesimit për bashkëpunim dhe në gjetjen e zgjidhjeve të reja, etj.

3.3 Metodika e kryerjes së V.N.M.-së

Studimi vlerësimit të ndikimit në mjedis u orientua;

- nga rëndësia e ndërtimit dhe shfrytëzimit të hapësirës ku është ndërtuar kanali ekzistues me standartet bashkëkohore,
- nga përmbushja e kërkesave vendase dhe të huaja,
- nga vendi ku ai ndodhet, pasuritë natyrore e humane të zonës si dhe vlerave të veçanta të tyre,
- në identifikimin e ndikimeve negative dhe lokale,
- marrjen e masave zbutëse, duke patur parasysh ruajtjen e interesave ekonomike të investimit,
- në masat orientuese për një zhvillim të qëndrueshëm etj.

Në këtë raport indentifikohen ndikimet lokale e negative në mjediset humane, si dhe është marv parasysh vlerësimi i rrezikut. Reduktimi i ndikimeve negative, është ndërthurur edhe me ndikime të rëndësishme lokale dhe strukturore në këto faza kyesore:

- Hartimi i objektivave orjentuese të V.N.M.-së;
- Verifikimi në terren i të dhënave ekzstuese dhe mbledhja e të dhënave biofizike dhe humane;
- Hartimi i V.N.M.-së dhe dorëzimi tek porositesit si dhe në subjektet vendimarrëse dhe kontrolluese të aspekteve mjedisore në nivel lokal dhe qëndror;

Për hartimin e raportit të VNM, porositiësi vuri në dispozicion të hartuesit të raportit materialin teknik të disponueshem, juridik e stafin e subjektit. Me bashkëpunimin e subjektit kërkues. MTM është autoriteti kompetent ligjor për të kërkuar, analizuar dhe aprovuar dokumentacionin e VNM, ku projekti në vlerësim do të nënshtrohet procedurave të raportit paraprak të VNM-së. Lidhur me gjendjen mjedisore të zonës së projektit u kërkuan informacione, studime, plane, projekte apo programe për këtë zonë.

Hartimi i Raportit të VNM-së është bërë në përputhje me:

Baza ligjore:

- Ligji Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 440”, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i ndryshuar.
- VKM Nr. 686, datë 29.7.2015, “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afatevepër zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore”.

Hapat që u ndoqën për hartimin e raportit të VNM-së janë:

1. Njohja me projektin teknik
2. Konsultimi me kuadrin ligjor
3. Rishikim i gjendjes aktuale mjedisore, për të evidentuar ndryshimet e mundshme, evulimet apo përmirësimet e saj nëpërmjet inspektimeve në terren

4. Evidentimi i impakteve negative të mundshme gjatë zhvillimit të projektit
5. Evidentimi i impakteve kumulative të mundshme nga aktivitetet e tjera që kryhen aktualisht në rajonin e projektit

6. Hartimi i masave për zbutjen e impakteve në mjedis dhe monitorimin në mjedis

Në bazë të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 440”, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, po fillojmë procedurat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

Klasifikimi:

Sipas shtojcës II “Projektet që i nënshtrohen procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis/ Pika 10. Prodhime infrastrukturore; b) Projekte për zhvillime urbane, duke përfshirë dhe ndërtimin e qendrave tregtare dhe parkimet për makinat”. Pika 12. Turizmi dhe koha e lire, d) Parqe tematike.

IV. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

4.1 Gjendja Ekzistuese

Në vitet 2019-2020 Bashkia Durrës ka realizuar investimin me objekt “Rehabilitim i Kanalit KUL, faza II dhe faza III”, i cili ka realizuar ndërtimin e kanalit të mbyllur me strukturë beton – arme. Mbulimi i këtij kanali është zgjedhur si alternativa më e mirë që do të shërbejë si rrugë lidhëse me rrugën kryesore “A.Goga”.

Gjithashtu aktualisht Bashkia Durrës po zbaton investimin me objekt “Rehabilitimi i Infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto-Romanos - Kënetë dhe sistemimi i rrjetit të ujrave të shiut në zonën urbane të Qytetit të Durrësit, Faza I”.

Të dyja këto investime kanë lidhje me të njëjtin kanal i cili është mbyllur për një gjatësi prej 1.08 km ku kërkohet të zhvillohet dhe projekti në fjalë për Parkun Urban Spitalë.

Përgjatë këtij aksi, nëntokë është kanali i kullimit të ujrave të shiut i cili ishte i ndotur nga ujrat e zeza dhe papastërti të ndryshme për shkak të ndërtimeve informale dhe pakujdesisë së komunitetit. Prej ndërhyrjes së Rrjetit të Ujësjiellit dhe Kanalizimeve Durrës u krye izolimi i kanalit duke i lënë mundësi të plotë rehabilitimit të tij dhe krijimin e një hapësire publike me gjerësi që varion nga 9 m deri në 10 m e cila propozohet si një park urban. Në gjëndjen ekzistuese rruga automobilistike nuk është e asfaltuar, mungojnë korsitë e biçikletave, hapësirat për lëvizjen dhe qëndrimin e kalimtarëve, hapësirat rekreative për grupmosha të ndryshme dhe një gjelbërim i sistemuar.

4.2 Statusi i zonës së studiuar dhe objektivi i projektit

Ky projekt parashikon të ndërhyjë me investime të reja në krijimin e një hapsirë të gjelbërt me hapsira rekreative për grupëmasha të ndryshme.

V.TREGUESIT E PROJEKTIT

Projekti parashikon ndërtimin e një parku urban linear mbi hapësirën e krijuar nga izolimi i kanalit KUL.

VI. EKONOMIA E ZONËS DHE AKTIVITETET KRYESORE TË SAJ

6.1 Statusi i zonës në studim

Në këtë zonë jetojnë banorët rezidentë, vizitore ditore dhe pushues në periudhën e verës. Kjo zonë historikisht dhe tradicionalisht, gjë që vazhdon edhe sot, ka gjetur zhvillim industria dhe peshkimi. Nga aktivitetet e mësipërme popullsia mbulon 80% të nevojave ekonomike.

6.2 Mendimi i Komunitetit

Për zhvillimin e këtij projekti investitori dhe firma projektuese kanë zhvilluar një degjesë të hapur me komunitetin përreth zonës ku do të zhvillohet parku urban linear. Një projekt i mirëpritur nga banorët për të patur një zonë të gjelbërt me hapësira rekreative si dhe si një mundësi zhvillimi ekonomik.

VII.PËRSHKRIMI I MJEDISIT TË ZONËS SË PROJEKTIT

7.1 Një përshkrim i shkurtër i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, (i shoqëruar dhe me imazhe)

Sipërfaqja e gjurmës ku do të zhvillohet projekti, zë një sipërfaqe prej 16000 m². Objekti që parashikohet të ndërtohet do të jetë jetë “Studim projektim Parku Urban -Spitalle, Durrës”.

Zona ku parashikohet projekti është një zonë që ndodhet në veri-perëndim të qytetit dhe përfshin lagjen 8 dhe 15, zona Spitallë e qytetit të Durrësit. Përgjatë gjithë sipërfaqes ku do të zhvillohet parku ndodhen banesa. Reilevi i zonës është kodrinor dhe nuk ka bimësi, përveç pjesës ku kalon përmes varrezave të vjetra të qytetit të Durrësit , përgjatë të cilës kemi pemë të larta të cilat do të jenë pjesë e integruar e projektit, nuk do të zëvendësohen.






Foto të bimësisë

Bashkia Durrës

Durrësi është një zonë urbane me një rritje të ndjeshme demografike, si dhe nga afërsia e tij me Tiranën ka një rol mjaft të rëndësishëm në rajon. Qyteti është në stadin e vështirë të identifikimit të rolit të tij në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, pasi ai është ende një nga qytet- portet më të rëndësishme të Adriatikut dhe pararojë për një zonë të ardhme metropolitane. Ky rol strategjik e vendos atë në pozicionin e favorshëm të vëzhguesit për fatin e kontekstit rajonal dhe ekstrarajonal

në të cilin ndodhen qytetet e Shqipërisë.

Durrësi është qyteti me aktivitetin më të madh ekonomik pas Tiranës, por urbanizmi i shpejtë dhe pa kriter ka krijuar një varg problemesh që pengojnë zhvillimin e qëndrueshëm.



Zona Gjeografike: Bashkia Durrës kufizohet në perëndim me Detin Adriatik, në veri me bashkinë Kurbin, në lindje me bashkitë Krujë, Vorë e Shijak dhe në jug me bashkinë Kavajë. Popullsia: Sipas censusit, në territorin e bashkisë së re Durrës banojnë 175,110 vetë ndërsa sipas regjistrit civil popullsia rezidente është 299,989 vetë. Me një sipërfaqe prej 338.30 kilometrash katrorë, densiteti i popullsisë sipas të dhënave të Censusit është 517 banorë km² ndërsa sipas Regjistrit Civil është 680 banorë km².

Kjo bashki përbëhet nga gjashtë njësi administrative, të cilat janë: Durrësi, Sukthi, Ishmi, Katundi i Ri, Rrashbulli dhe Manëz. Të gjitha njësitë e bashkisë së re bëjnë pjesë në rrethin Durrës, qarku Durrës. Në territorin e bashkisë së re gjenden tre qytete, Durrës, Sukth dhe Manëz si dhe 39 fshatra.

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrit Civil	Sipërfaqja KM ²
Durrës	Qyteti Durrës	Durrës	Qyteti Durrës	175,110	299,989	338.3
		Sukth	Qyteti Sukth, Fshatrat; Hamallaj, Kullë, Perlat, Vadardhë, Rushkull, Hidrovori			
		Ishëm	Fshatrat; Likmetaj, Kërtushaj, Kapidanaj, Gjuricaj, Lalëz, Kuraten, Bizë, Draç, Shetaj,			
		Katundi i ri	Fshatrat; Katundi i ri, Jubë, Qerret, Fllakë, Bisht-Kamëz, Rinia, Erzen, Sukth, Adriatik			
		Rrashbull	Fshatrat; Rrashbull, Arapaj, Shënavlash, Shkallnur, Manskuri, Romanat, Bozanxhije, Xhafzotaj,			
		Manëz	Qyteti Manëz, Fshatrat; Armath, Borç, Hamallaj, Kameronas, Radë, Shkallë, Fshat Manëz			

Profili i Bashkisë

Bashkia e Durrësit shtrihet përgjatë bregut të detit, nga grykëderdhja e lumit Ishëm në veri deri në kufi me Kavajën në jug. Vija e gjatë bregdetare që i shtohet qytetit të Durrësit e thekson tiparin e kësaj bashkie si zonë turistike, pasi përveç plazhit të Durrësit asaj i shtohet i gjithë gjiri i Lalëzit si dhe Kepi i Rodonit, të cilat deri tani kanë qenë pjesë e komunave Ishëm, Sukth, Katund i Ri dhe Rrashbull. Durrësi ka gjithashtu portin më të madh në Shqipëri, ku përpunohet mbi 90 për qind e të gjithë volumit të ngarkim-shkarkimit portual, gjë që e bën atë një nga më të rëndësishme tregtare në vend. Për shkak të lehtësisë që krijon porti, Durrësi është zhvilluar edhe si një qytet i rëndësishëm për manufakturën, ndërsa joshja nga turizmi ka shkaktuar gjatë dy dekadave të fundit një bum në sektorin e ndërtimit. Durrësi është një zonë me shkallë të lartë të migrimit të brendshëm, gjë që ka sjellë zgjerimin e shpejtë dhe informal të qytetit në zonën e ish-Kënetës si dhe përgjatë vijës bregdetare në jug të qytetit.

Durrësi është gjithashtu një zonë e rëndësishme arkeologjike, pasi nën qytetin aktual gjenden disa shtresa qytetërimesh antike. Zbulimet arkeologjike janë të shumta, ndërsa ndërtimet e dekadave të fundit kanë dëmtuar një pjesë të kësaj trashëgimie. Me mbi 5600 aktivitetet ekonomike të tij dhe 15% të investimeve të huaja, Durrësi është renditur në vendin e dytë si ekonomia më e fortë e vendit, pas Tiranës. Turizmi veror dhe kulturor është një industri me ndikim të rëndësishëm në ekonominë e Durrësit. Me mbi 750.000 vizitorë në vit, kjo është zona më e rëndësishme e vendit në lidhje me turizmin masiv. Sipas Zyrës Rajonale të Punës të Durrësit, forcat aktive për të punuar llogariten rreth 54,000 njerëz. Niveli i të papunëve për rrethin e Durrësit shkon në rreth 10,38%, ku papunësia është më e përhapur te femrat. Sektori privat ka punësuar rreth 31,3%, i ndjekur nga sektori bujqësor privat me 36,7%, dhe sektori shtetëror me 21.3%.

Mjedisi natyror

Zona ku ndodhet qyteti i Durrësit karakterizohet nga biodiversiteti i tipit mesdhetare.

Llojshmeria e habitateve ku spikat diversiteti floristik shtrihet kryesisht në një riliev kodrinor përreth qytetit si dhe zonat e rrafshata të tij ose ku zhvillohet aktivitet kryesisht bujqësor. Vegjetacioni i zonës është i kondicionuara nga një serë faktorësh klimatik, edafik, e të rilievit. Për të vlerësuar më mirë mbulesen bimore vendosemi në kontekstin fiziko gjeografike të rajonit. Përgjithësisht bimësia natyrore e zonës së Durrësit karakterizohet nga një larmi llojesh si rezultati një ndryshueshmëri e të kushteve ekologjike e edafike të krijuara nga kombinimi i llojeve të tokës, reshjeve dhe pozicionit topografik. Në gjëndjen e sotme të habitateve veçanërisht në shperndarjen e bimësisë shprehet dhe ndikimi i madh i aktivitetit gjatë gjithë periudhave. Në zonën e dunave të plazheve (dunat janë të dëmtuara) dallohen vatra me një fizionomi të vegjetacionit të marrë nga shoqërimet me llojet *Cakile maritima*, *Xanthium strumarium*, *Ammophila*, *Cyperus capitatus*, *Sporobolus pungens*, *Echinophora spinosa*, *Eryngium maritimum*, *Medicago marina* etj. Ndërsa gjandën dhe bimët me status të rrezikuar si *Stachysmaritima*, *Panocratium maritimum*, *Ammophila arenaria*,. Sidomos në zonat e sheshta, larmia florës barishtore përfaqësohet me një gradë më të madhe mbulimi me llojetë familjeve Graminacea e Leguminacea si *Festucasp*, *Trifolium*, *Viciaspp*, *Urtica dioica*, *Sanguisorba officinalis*, *Salvia sp*, *Melisa officinalis*, Lulëkuqja (*Papaver rhoeas*), Bari i bletës (*Melisa officinalis*) Çikorja (*Cichorium intybus*), etj si dhe disa prej tyre kanë rëndësi mjeksore.. Flora drusore e shkurre natyrore dominohet nga prezenca e pishës bregdetare (*Pinus sp.*) Dëllinjën (*Juniperussp*), Frasherin (*Fraxinus angustifolia*) Shelgun Shqopën (*Ericasp*), (*salixsp*), Plepat(*Populus spp*), Selvinë (*Cupressus sempervirens*), Gjineshtrën (*Spartium junceum*), Trëndafilinë egër (*Rosacanina*), Manaferra (*Rubusfruticosus*) etj. Në mjaft rrugë të qytetit sidomos ajo e hyrjes deri tek Stacioni I Trenit janë mbjellë drurë dekorative të cilat e pasurojnë mjedisin urban të qytetit me elementë floristike me një ndikim pozitiv të pazëvendësueshëm jo vetëm në aspektin pejsazhist por dhe në cilësinë e mjedisit urban nëtërësi. Në mjediset e patrajuara plotësisht me infrastrukturë urbane, në hapësirat që pritet të zhvillohet, në anë të rrugeve të pasaflluara e vendeve të ngritura, gjanden bimë të tilla si Podiqja e eger (*Agrimonia eupatoria*), thundermushka (*Tussilago farfara L.*), kamomili i qenit (*Anthemis cotula*), cikorja (*Cichorium intybus L.*), lule dhensh (*Bels perenis L.*) kin fushe (*Erithrea centarium*), terfili i arave (*Trifolium arvense*) si dhe mjaft bime graminore. Në mjediset me të ulta ku ndjehet prezenca e ujrave nëntoksore, në kanale kulluese, takohen bimë të tilla si bargjaku (*Lythrum salicaria L.*) bimë të familjeve graminore si kuqela e ravenes (*Erianthus ravenua P.B.*), mendra (*Menta piperita L.*) mendra gjethegjate (*Mentha longifolia L.*), menta e eger (*Menta pulegium L.*) menta e ujit, (*Menta aquatica*). Mjaft bimë barishtore që karakteristike të kësaj zone kanë vlera mjeksore si *Festucasp*, *Melisa officinalis* *Trifolium*, *Sanguisorba officinalis*, *Viciaspp*, *Salvia sp*, *Urtica dioica*, Lulëkuqja (*Papaver rhoeas*), Çikorja (*Cichorium intybus*), Bari i bletës (*Melisa officinalis*) etj.

Hapësira te gjelbërta dhe të mbrojtura

Qyteti i Durrësit ka sipërfaqe dhe hapësira të gjelbërta, ku përfshihen parqet e ndryshme rrugët me gjelbërim të qytetit si dhe zonat përreth qytetit. Në tabelat në vijim1 (sipërfaqe te gjelbërta të qytetit të Durrësit nëpër rrugët e qytetit dhe parqet e tij.

Nr.	Emërtimi(sipërfaqja e gjelbër në rrugë)	Gjatësia	Sip.m ²
1	Rr. Dalip Peza + Isa Boletini	560	2688
2	Rr. J.Ballhysa + Hajdar Bardhi + Hysen Myshketa	730	3504
3	Rr. MujoUlqinaku	1280	6144
4	Rr. Maliq Muco(H. Kaculini)	380	1824

5	Rr. Shoqëria Bashkimi	380	1824
6	Rr. Bulevardi Kryesor Shëtitorja Dyrrah	620	2976
7	Rr. Epidam (Rr. Tregtare)	570	2736
8	Rr. Haziz Podgorica (Fermentimi-St.Plazhit)	380	1824
9	Rr.Shëtitorja Egnatia (Rr.Skenderbej)	1080	5184
10	Rr. Adria + Bulevardi Dëshmorëve	1820	8736
11	Rr. Epikadeve (Rr. De Rada)	200	960
12	Rr.A.Celkupa+ KocoKazanxhi	670	3216
13	Rr. NekiLibohova + Pjetër Hanxhari	670	3216
14	Rr. Hysen Kërtusha	1080	5184
15	Rr. F.Durrsaku + G.Durrsaku	210	1008
16	Rr. Taulantia	480	2304
17	Rr. Aleksander Goga	1280	6144
18	Totali i NSHK Durrës	12390	59472
19	Rr. BajramTusha (Shkozeti)	1100	5280

r.	Emërtimi(sipërfaqe te parqeve të qytetit)	Sip.m ²
1	Parku i Vilës	40000
2	Qendra(Pallati A.Moisiu +Prefektura+Cedrus + Sokati)	6460
3	Muzeumi	8830
4	Centrali	468
5	Stacionii trenit+ para pallatit	3572
6	Gjethja	1684
7	Shiriti i Rr. MujoUlqinaku	896
8	Lulishtja A.Durrsaku +Monumenti I Mujo Ulqinakut	3900
9	GrupikryqëzimiiPortit (Porti+Torra + Pionieri)	4718
10	Pionieri +Befotrofi	5179
11	20Shkurti	2925
12	Pallati i Sportit	4847
13	ShëtitorjaTaulantia	50096
14	Parku në hyrjetë Durrësit	13689
TOTALI		147264


Ndërtimi gjeologjik

Zona e studiuar hyn në gjysmën lindore të zonës tektonike Jonike. Strukturat e ngritura antiklinale në veri, jug dhe lindje ndërtohet nga formacionet mullasike Neogjenike. Në sheshin e ndërtimit këto pësojnë një fundosje në nivelin e detit, me një diskordance të theksuar, mbulohen me formacionet zhavorrore të Plio-Kuaternarit dhe nga depozitimet e shkrifëta suargjilore të Kuaternarit të ri; Historikisht procesi i mbushjes në pjesën e brendshme ka filluar që me mbarimin e Pliocenit, epoke kjo kur deti që futur rishtas në brendësi të sterës duke krijuar gjire të theksuar, në strukturën sinklinale, gadishuj të zgjatura sipas strukturave antiklinale, kepe dhe ishuj të shumtë. Në Kuaternarin e vjetër kemi zbrapsjen e detit dhe intensifikimin e

gërryerjes dhe herë vërshime kah sterës dhe intensifikimin e akumulimit në tarraca të reja me konglomerat në shumë vende. Në zonën tonë lumenjtë e mirënjohur Shkumbini, Erzeni kanë krijuar lugina dhe akumulimin e tyre përgjatë sinklinalit dhe në raste të veçanta kanë ndërprerë dhe struktura antiklinale. Prania e rërave bregdetare, mbi suargjilat lagunore - kënetore e aluviale, tregon qartë se për pas prishjes së rregjimit të akumulimit të suargjilave, ka ndodhur zhytje dhe mbulimi i sipërfaqes së dikurshme me rëra plazhi. Për zhytjen e sipërfaqes aktuale dëshmojnë edhe të dhënat e objekteve arkeologjike, që sot gjenden në nivele më të ulëta sesa 2000 deri 2500vjet më parë. Pra duke njohur karakteristikat e përgjithshme gjeomorfostrukturale të zonës mund të kalojmë në përshkrimin e njësive litostratigrafike të bazamentit Mullasik të Neogjenit dhe mandej atë të Kuaternarit. Depozitimet e Neogjenit ndahen në ato të Miocenit të Sipërm dhe të Pliocenit. Depozitimet e Miocenit- Përfaqësohen nga stiva ranorësh të Tottonianit dhe ranore alevrolote të Miocenit të Sipërm. Depozitimet e Pliocenit - Këto përfaqësohen nga suita e "Helsesit" dhe suita e "Rrogzhinës", e cila përbëhet kryesisht nga alevrolite dhe me pako ranori kokërrimët e argjilite. Njësitë litostratigrafike tifmbulesi Pliokuaternarit dhe Kuaternarit. Depozitimet e mbulesës pliokuaternarit kanë një përhapje të gjerë në bregdetin akumulativ ku futet edhe sheshi i ndërtimit të studiuar nga ana jonë. Depozitimet pliocen kuaternarit (N2O1): Këto depozitime nuk janë takuar në zonën e studiuar, por janë takuar në zona të tjera të largëta, janë kapur nga shpimet hidrogeologjike, përfaqësohen nga rëra e zhavorre të pa çimentuara ose të çimentuara dobët dhe gjenden në nivelet 50-150m, nga sipërfaqja e tokës natyrale Depozitimet e Kuaternarit të Ri (Q4): Këto depozitime në sheshin e ndërtimit janë depozitime detare-lagunore. Mbi sipërfaqen e tarracës abrazive të përberë nga argjilite dhe alevrolite të suitës së "Rrogzhinës", zhvillohet kjo prerje e përgjithshme duke u renditur nga lartë poshtë.

Sizmiciteti

Në vendin tonë janë përcaktuar zonat e burimeve sizmike janë terrene që kanë një aktivitet sizmik të dallueshem. Shqipëria është një ndër vendet me sizmioaktive në Evropë. Sizmiciteti i Shqipërisë karakterizohet nga një mikroaktivitet sizmik intensiv ($1.0 < M < M < 7$) dhe shumë rrallë nga tërmete të fortë ($M > 7.0$). Shumica e tërmete të fortë ndodhin në 3 breza sizmike mire të përcaktuar, si vijon: Brezi termotor Joniko-Adriatik, në buzën lindore të mikroplakës së Adrias me shtrirje veriperëndim – juglindje Brezi termotor Peshkopi – Korçë, me shtrirje veri-jug, Brezi termotor Elbasan – Dibër, me shtrirje verilindore




Harta e rrezikut sizmik dhe Harqet kryesore sizmike

Por, zona me rrezik të lartë mund të rezultojnë edhe rajone të tjera të vendit që karakterizohen nga troje të dobëta, të paqëndrueshme (të shkruftë, lymra, torfa, troje të ngopura me ujë, troje në terrene të rrëshqitshëm dhe me pjerrësi të madhe, troje në afërsi të thyerjeve tektonike aktive, etj) të cilat e rrisin ndjeshëm efektin sizmik edhe kur ndodhin tërmete më të “vegjël” në madhësi.

Vlen të theksojmë se rajoni i Durrësit u godit nga disa tërmete të fortë gjatë vitit 2019

Veçori klimatike dhe kushtet hidrologjike

Sipas ndarjes klimatike të Shqipërisë zona në studim bën pjesë në Nën Zonën Mesdhetare Fushore Qendrore. Përmasat e kufizuara të Ultësirës Perëndimore dhe relievi i saj, pak a shume i rrafshet, bëjnë që ajo, në tërësinë e saj, të përfaqësojë një njësi të vetme klimatike. Ndikimi i faktorëve klimë formues, në tërë shtrirjen e tyre, ushtrohet pothuajse në të njëjtën kohë dhe ndryshimet në vlerat e elementeve meteorologjike, nga një rajon në tjetrin, janë gjithnjë sasiore. Të gjithë faktorët klimë formues janë të ndërlidhur me njëri-tjetrin dhe të kushtëzuar nga njëri-tjetri. Ecuria e njërit bëhet shkas për ndryshime të rëndësishme tek tjetri. Është kjo arsyeja që, megjithëse ndikimi i këtyre faktorëve analizohet për secilin veç e veç, përsëri ata nuk mund të ndahen. Kufiri perëndimor i Ultësirës laget, pothuajse tërësisht, nga ujërat e detit Adriatik kështu që, në një masë ose në tjetrën, e gjithë sipërfaqja e saj i nënshtrohet ndikimit të tij



Harta e Zonave Klimatike

Era

Në Ultësirën Perëndimore drejtimi i erës gjate vitit është I ndryshueshëm. Përse i përket ndikimit të detit në regjimin e drejtimit të erërave vërehet se ai më mirë shfaqet në stinën e verës. Në verë, në territorin e Ultësirës Perëndimore, erat mbizotëruese janë ato të kuadratit të perëndimit, sidomos erërat veriperëndimore. Në stinën e dimrit, në territorin e Ultësirës

Perëndimore, më shpesh rastisen erërat e kuadratit të lindjes. Në stinën e dimrit shpejtësitë mesatare të erës në territorin e Ultësirës luhaten ndërmjet 1.6-5.7 m/s. Stina e verës karakterizohet nga shpejtësi më të vogla të erës për shkak të mbizotërimit të motit anticiklonar. Brenda territorit të Ultësirës Perëndimore ato luhaten ndërmjet 1.5-4.1 m/s. Në pranverë dhe në vjeshtë fusha termobarike, pëson ndryshime rrënjësore në krahasim me dimrin dhe verën. Në këto stinë gradientët barikë janë më të vegjël se në dimër dhe më të mëdhenj se në verë.

Temperaturat e Ajrit

Temperatura e ajrit në gjithë Ultësira Bregdetare (ku ndodhet zona në studim) gjenden nën ndikimin e fuqishëm të detit Adriatik. Një nga parametrat më të rëndësishëm të temperaturës së ajrit është temperatura mesatare e tij. Temperatura mesatare e ajrit është më e ulët në muajin janar 6.9 oC dhe më e larta në muajin korrik dhe gushtë 23.8 oC.

Lagështia e Ajrit

Ndryshimi i lagështirës relative të ajrit gjate vitit është në varësi të ngushtë me ecurinë e temperaturës së ajrit nga njëri muaj në tjetrin, duke qënë e ndikuar në mënyre të veçante nga karakteristikat lokale të relievit dhe veçoritë e qarkullimit të masave ajrore në çdo stinë dhe muaj të vitit. Gjate muajve të verës vlerat mesatare të lagështirës relative të ajrit janë më të ulëta, sidomos në muajt korrik dhe gusht, që janë muajt më të ngrohtë të vitit.

Rreshjet Atmosferike

Regjimi i reshjeve në territorin e Ultësirës Perëndimore është i lidhur ngushtësisht me veprimtarinë ciklonare si dhe atë anticiklonare. Deti Adriatik, pozita gjeografike e Ultësirës si dhe relievi që e rrethon atë, janë gjithashtu faktorë të rëndësishëm prej të cilëve varet shume mënyra e shpërndarjes së reshjeve. Nga analiza e reshjeve vjetore, gjysmës së ngrohtë e të ftohtë si dhe ato stinore, mund të nxjerrim një ligjësi të shpërndarjes që është rezultat i ndikimit të relievit që e rrethon. Lartësitë e reshjeve kane tendencën e përgjithshme që, duke kaluar nga perëndimi për në lindje, të rriten, ligjësi kjo e cila e shqyrtuar për të gjithë territorin e vendi është e kundërt. Ndikim mbi shpërndarjen e reshjeve, sidomos gjatë gjysmës së ngrohtë të vitit, kanë edhe brizat detare. Prania e brizave sjell për pasojë prishjen e konveksionit termik, rrjedhimisht të kushteve të përshtatshme për krijimin e reve të zhvillimit vertikal. Prandaj në periudhën e verës pjesa perëndimore e Ultësirës ka reshje deri dy herë më pak se ajo lindore ku brizat gjithashtu dobësojnë konveksionin termik, por jo në atë masë sa në pjesën perëndimore. Qarkullimi i atmosferës ka karakter të theksuar stinor. Ai ndryshon në mënyre graduale nga muaji në muaj. Ky ndryshim i qarkullimit pasqyrohet në sasi të mujore të reshjeve. Muajt e stinës së dimrit karakterizohen në mbizotërimit të veprimtarisë ciklonare. Kjo veprimtari është më e theksuar në muajt nëntor-shkurt. Në stinët kalimtare, pranverë e vjeshtë veprimtaria ciklonare dobësohet dhe në verë pothuajse zëvendësohet plotësisht nga veprimtaria anticiklonare. Për shkak të mësipërme, muajt me më shumë reshje janë nëntori, dhjetori, janari e shkurti.

Niveli i Detit


Lëkundjet baticore në bregdetin tonë janë të dobëta amplituda mesatare e lëkundjeve ditore ndryshon nga 20 deri 30 cm

Zonat e Mbrojtura

Në qarkun e Durrësit ndodhen rreth 10 Zona të Mbrojtura të kategorive të ndryshme.

LISTA E ZONAVE TË MBROJTURA - QARKU DURRËS							
NR.	EMËRTIMI I ZONËS	ADRESA					TË DHËNA TË SHPALLJES
		LAGJJA	FSHATI	NJËSIA ADMIN.	BASHKIA	QARKU	INSTITUCIONI/ NR. VENDIMIT/ DATA
1	Qyteti i Durrësit (pjesa e vjetër dhe nëntoka) Qytet Muze ; Rregullore mbi mbrojtjen, restaurimin dhe administrimin e nëntokës së qytetit të Durrësit				Durrës	Durrës	Vendim i Këshillit të Ministrave/ 172/ dt. 02.06.1961; dt.17.04.1989
2	PAZARI I VJETËR I KRUIJËS (QYTET-MUZE)				Krujë	Durrës	Vendim i Këshillit të Ministrave/ 172/ dt. 02.06.1961
3	ZONAT ARKEOLOGJIKE "A" DHE "B" TË QYTETIT TE DURRËSIT DHE PLANI PER RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE ADMINISTRIMIN E TYRE				Durrës	Durrës	Vendim i Këshillit të Ministrave/ nr.786/ dt.26.12.2018
4	ZONA ARKEOLOGJIKE "A" DHE "B" DHE QENDRA HISTORIKE E QYTETIT TE KRUIJËS			Krujë	Krujë	Durrës	Këshilli i Ministrave/ nr. 427/ dt.20.06.2012
5	ZONA E MBROJTUR E KALASË SË ISHMIT			Ishëm	Durrës	Durrës	Ministria e Kulturës / nr.251/ dt. 25.09.2014
6	ZONA E MBROJTUR E KALASË E CURRILAVE" NË FSHATIN E SKËNDËRBEUT				Durrës	Durrës	Ministria e Kulturës / nr.43/ dt.02.02.2015
7	ZONA E MBROJTUR E KISHËS SË SHËN NDOIT				Durrës	Durrës	Ministria e Kulturës /nr. 39/ dt. 02.02.2015
8	ZONA MBROJTËSE E KISHËS SË GJON PAGËZORIT		Derven	Thumanë	Krujë	Durrës	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve/ Urdhër nr. 945/ dt.07.11.2008
9	ZONA E MBROJTUR E RRËNOJAVE TE TEQESË SË VJETËR DHE SHPELLA E SARI SALLTIKUT			Krujë	Krujë	Durrës	Ministria e Kulturës/ nr. 109/ dt. 26.04.2016
10	ZONA E MBROJTUR "MURET E PORTËS", PORTO ROMANO				Durrës	Durrës	Ministria e Kulturës/nr.180/dt.03.06.2016

Lista e Zonave të Mbrojtura në qarkun Durrës.’’



Projekti ndodhet 1.70 km larg zonës Arkeologjike A e qytetit te Durrësit

7.2. Informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të saj

Bashkia Durrës laget nga brigjet e detit Adriatik. Deti Adriatik (shk. Adriatiku) (në italisht Mare Adriatico) është një pjesë e Detit Mesdhe, që ndan Gadishullin Apenin nga Gadishulli Ballkanik. Bregu perëndimor i Detit Adriatik është Italia, kurse në lindje deti lag brigjet e Sllovenisë, Kroacisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Malit të Zi dhe së fundi Shqipërisë deri në Vlorë, ky qytet në jug të së cilit gjendet Deti Jon. Ka një sipërfaqe 138.595 km katrorë, thellësia më e madhe arrinë 1330m. Temperatura mesatare e ujit në korrik arrinë 23,2 gradë celsius, ndërsa ajo mesatare vjetore 17,5 gradë celsius. Në jug saliniteti arrinë 38,32 promila, dukshmëria në bregdet është 5m ndërsa në brendësi deri 45m.

Deti Adriatik është njëri prej dy deteve që lag brigjet e Shqipërisë. Bregu përgjate tij është kryesisht një breg ranor. Në këtë det derdhen shtatë lumenj që rrjedhin përmes tokave shqiptare si: Drini i Bardhë, Drini i Zi, Vjosa, Buna, Mati, Shkumbini dhe Semani. Mjedisitë detare është një nga trupat ujore më të rëndësishme të Bashkisë Durrës dhe përbëhet nga disa elemente, të cilët duhen marrë në konsideratë për ta ruajtur atë. Qeveria Shqiptare përmes rregullores Nr.177 të 31.03.2005, përcakton qartë rregullat për ruajtjen e këtij mjedisi të rëndësishëm. Në vijën bregdetare me gjatësi të konsiderueshme të bashkisë Durrës ndodhen disa sipërfaqe që përdoren për plazh në muajt e verës dhe kështu merr rëndësi të veçantë pastërtia e tyre si dhe e ujrave detare që i lagin. Situata në disa prej plazheve ka qënë e përkeqësuar nga ndotjet ndërsa vitet e fundit (2014) rezultoi në përmirësuar. Ndotja ka ardhur nga numri I madh I ndërtimeve, mungesa e një sistemi kanalizimesh për ujërat e zeza dhe urbane, mungesa e impiantit përpunues të tyre, numri I madh I pushuesve

dhe mungesa e shërbimeve higjieno-sanitarenë plazhet përkatëse, prania e portit më të madh të vendit si dhe nga mungesa e edukatës qytetare.

Monitorimi I ujit të detit në zona të ndryshme në Durrës ²							
NR	ADRESA	NO ₂	NH ₄	pH	Analizat mikrobiologjike		
					Coliforme	E.coli	St.Faecal
1	Pistae Kokeve	ndot	ndot	8.24	+93	+93	--
2	Kështjella	ndot	ndot	8.29	+43	+43	--


Ujërat sipërfaqësore dhe ato nëntokësore

Në basenin Ishëm-Erzen paraqitet një situatë e ndryshme nga stacioni në stacion për sa i përket të gjithën treguesve të cilësisë së ujrave. Për 3 stacionet e lumit Ishëm vlera e O të tretur paraqitet e moderuar e klasifikohet e cilësisë së tretë. Tre stacionet e lumit Erzen rezultojnë të pasura me oksigjen dhe klasifikohet të cilësisës së parë, ku veçojmë stacionin referencë me përmbajtje më të lartë 9.53 mg/l. Ndërsa përsa I përketë përmbajtjes së NBO si dhe e NKO për Ishëm gjendja paraqitet problematike duke e kaluar nivelin e cilësisë së keqe (klasa e pestë). Situata paraqitet problematike edhe për përmbajtjen e NO₂, NO₃. Shkaqet për këtë gjendje janë shkarkimet e lëngeta urbane të patrajtuara si dhe shkarkimet industriale të subjekteve të zonës së autostradës. Ujërat e cilësisë së ulët në të keqe paraiten edhe për përmbajtjen mesatë të fororit (ujërat e lumit të Tiranës dhe të Lanës që shkarkojnë në Ishëm). Vlera më e lartë të përmbajtjes së amonjakut NH₄ paraqitet në lumin e Lanës tek Ish dogana që ndodhet pas shkarkimit të kolektoreve të ujërave urbane, të cilat janë përgjegjëse direkte për këto vlera. Po kështu paraqitet situatë edhe për lumin Erzen në stacionet e fundit. Sipas Raportit për Gjendjen e Mjedisit në R.SH. (2014) rezultojnë Ujërat e lumenjve vlerësohen alkaline me pH nga 7-8.3. Lumi i Ishmit dhe Erzen vlerësohen me përcjellshmëri të lartë elektrike që tregon ndikimin e vazhdueshëm të shkarkimeve urbane e industriale dhe lumi i Ishmit është kritik dhe përsa I përket përmbajtje NBO, P, që tregon prezencën e fuqishme të ndotjeve urbane dhe industriale. Kjo vërehet dhe nga përmbajtja e lartë e amonjakut nga shkarkimet e ujrave urbane të patrajtuara e industriale të lumit të Tiranës dhe të Lanës. Lumi i Ishmit mbetet lumi më i ndotur në Shqipëri. Nga monitorimi i ujërave bregdetare është problematike sidomos në Porto Romano ku bëhen shkarkime urbane të patrajtuara. Kjo situatë do të përmirësohet me vënien në kapacitet të plote të impiantit të trajtimit të ujërave urbane. Gjatë vijës bregdetare në Durrës ka mjaft kanale e rrjedha të ndryshme që derdhen në det duke sjellë ndotjen e ujërave bregdetare e bërë rrezik potencial për pushuesit në sezonin e verës. Ujërat nëntokësore janë pasuria më e rendësi jetike për popullatën dhe janë objekt shfrytëzimi i vazhdueshëm me intensitet të lartë rritje dhe rrisht të përhershëm ndotje nga veprimtaritë natyrore e njerzore. Për këtë arsye më e rendësi të veçantë monitorimi i tyre. Në basenin e Erzen - Ishëm monitorohet akuiferi ujëmbajtës i zhavorëve të Kuaternarit të Tiranës me një rrjet monitorimi me 5 shpime dhe akuiferi ujëmbajtës i zhavorëve të Fushe - Krujës me 4 shpime. Për vitin 2014 rezultojnë koeficienti vjetor i shfrytëzimit në Tiranë K = 0,85 - 0,95. Ndërsa temperatura mesatare e ujit ka rezultuar 17,21°C (norma 8 - 15, deri 20) ndërsa vlera mesatare e pH për vitet 2010 - 2014 ka variuar 7,18 - 7,35. Vlerat mesatare të fortësisë së përgjithshme kanë variuar për vitet 2010 - 2014 në 19,37 - 25,42 mg/l. Mineralizimi i përgjithshëm mesatar për vitet 2010-2014 varion M_p = 621,8 - 866,67 mg/l. Uji është i tipit hidrokarbonat - kalcium- magnez. Përmbajtja mesatare e Na për vitet 2010 - 2014 varion 25,99 - 77,8 mg/l ndërsa Mbetja thatë mesatare varion 419-534,5 mg/l. Përmbajtja mesatare e Ca për vitet 2010 - 2014 varion 105,44 - 132,27 mg/l. Përmbajtja mesatare e Ca për vitet 2010 - 2014 varion 19,26 - 34,1 mg/l dhe e Fe 0 - 0,04 - 0,06 mg/l. Po kështu, Përmbajtja

mesatare e Cl për vitet 2010 -2014 varion 25. 64 -62. 76 mg/l, e sulfateve (SO₄) varion 49. 03 - 95. 73 mg/l, e nitrateve (NO₃) 11. 11 - 23. 47 mg/l dhe e nitriteve (NO₂) është në sasinë nën 0. 01 mg/l deri në 0. 01 mg/l. Zona ku shtrihet qyteti i Durrësit është i pasur me ujëra nëntokësore në nivelit të ceket që rrit në këtë mënyre vulnerabilitetin për t'u ndotur. Shtresëzimet ujëmbajtëse ushqehen nga ujrat e lumit Ishëm dhe Erzen. Këto ujëra janë të pijshëm dhe kanë pH prej 7 deri 9. Sipas specialisteve, këto ujëra rrezikojnë të ndoten nga prania në zonën e kënetës të vendgrumbullimit të mbetjeve, nga ndotja e mëparshme e mjedisit dhe tokës në zonën e lindanit dhe të bikromateve, nga ish fabrika e prodhimit të kimikateve me bazë sulfur. Nga monitorimet e kryera për zonë rezulton se përqendrimi i lindanit në zonë zvogëlohet shumë qoftë në drejtim horizontal ashtu edhe në drejtim vertikal, p.sh në thellësi 20 cm përqendrimi i lindanit është rreth 4 herë më i madh se në thellësinë 80 cm duke bërë që të mendohet se në thellësi 5-6 m sasia e tij zvogëlohet në përqendrime të pallogaritshme. Gjithashtu edhe ndërtimi i parkut energjetik në zonën e Porto Romanos krijon një rrezik edhe për ndotjen e ujërave nëntokësore. Është i njohur fakti se burimet kryesore të ndotjes janë dhe mbetjet urbane (mbetje inerte dhe të lëngshme). Ndotja e ujit urban ndodh nga prania e P (fosforit) që e ka burimin nga detergjente të ndryshëm që përdoren kryesisht prej familjeve. Nitratet (Azotet) janë një tjetër element ndotës i gjendur në ujë, në formën e NO₂ dhe NO₃, që vjen prej aktiviteteve urbane, bujqësore dhe industriale. Ndotja më e madhe e ujit është ndotja mikrobiologjike që shkaktohet nga ujërat e zeza dhe që përfundojnë pa trajtimin e tyre, në lumenj dhe në forma të tjera në anë të rrugëve dhe kanalet natyrore të drenazhimit dhe përfundimisht derdhja e tyre në det.

Uji i pijshëm

Durrësi furnizohet dhe nxjerr ujë të pijshëm nga burimet ujore të Fushë Kuqes. Një pjesë e madhe e sistemit ekzistues ka qenë rinovuar dhe uji i burimit është higjenikisht i sigurt. Kjo bën që uji i pijshëm që vjen në rubinete të jetë i sigurtë. Gjithashtu në disa zona populata përdor ujin e puseve, i cili duhet kontrolluar në mënyrë rigoroze duke pasur parasysh ndotjet e ujërave të cekta nëntokësore në zonën e Durrësit. Plotësimi i nevojave në rritje të Durrësit mendohet se do të bëhet përmes prurjeve të reja nga Bovilla e Tiranës. Kjo do të thotë që prurjet në Durrës do të dyfishohen nga 350 l/s në rreth 700 l/s. Duke u bazuar në vlerat e vetive fizikokimike dhe atyre bakteriologjike të marra nga Instituti i Shëndetit Publik, cilësia e ujit të pijshëm është pothuajse brenda gjithë standardeve kombëtare.



Harta Hidrogeologjike

Në afërsi këtij territori nuk ka ujëra mbi e nën tokësorë të cilat do të çënohen nga ky projekt. Në një distancë prej 4.2 km ndodhet Ujëmbledhësi Spitallës dhe në një distancë prej 0.45 km ndodhet Rezervuari Spitallës. Deti Adriatik ndodhet në një distancë larg projektit 2 km.

c) Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër

Ky raport hartohet mbi bazën e parimit të mbrojtjes së mjedisit dhe në funksion të institucioneve vendim-marrëse për liçensimin ose jo të aktiviteteve të ndryshme të cilat mund të kenë ndikim në mjedis. Me mbrojtje të mjedisit do të kuptojmë veprimtaritë të cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet bazë të mbrojtjes së mjedisit të cilat janë:

- Parimet e mbrojtjes së mjedisit
- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes së integruar
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi "Ndotësi paguan"
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit nënkupton mbrojtjen e integruar të përbërësve të mjedisit nga ndotja, si veçmas, ashtu dhe në kombinim, duke pasur parasysh ndërveprimet ndërmjet tyre dhe qysh në fazën e planifikimit të zhvillimit të një territori të caktuar.

Mbrojtja e përbërësve të mjedisit klasifikohet në:

- Mbrojtja e ajrit
- Mbrojtja e ujërave
- Mbrojtja e tokës
- Mbrojtja e natyres
- Ndryshimet klimatike

8. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS NGA ZBATIMI I PROJEKTIT

Nga vlerësimi i veçorive kryesore të projektit dhe me investigimet në zonën e parashikuar për ndërtimin e parkut urban është bërë identifikimi dhe rivlerësimi i ndikimeve të mundshme në mjedis . Në përputhje me Udhëzimin Nr.6, datë 27.12.2006 “Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis të një veprimtarie” me këto identifikime dhe vlerësime është plotësuar tabela e Aneksit II të këtij udhëzimi për të analizuar në mënyrë të detajuar vlerësimet sasiore të ndikimeve në mjedis nga zbatimi i projektit të ndërtimit të parkut urban linear.

**IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS NGA ZBATIMI I PROJEKTIT
“STUDIM PROJEKTIM PARKU URBAN – SPITALLË”, BASHKIA DURRËS**

Nr	Pyetje që konsiderohen në fazën e përzgjedhjes	Po/Jo	Cilët elemente të mjedisit mund të ndikojnë/ si?	Do të jetë ndikimi domethënës në mjedis? Pse?
1 A do të përfshijë ndërtimi, operimi ose mbyllja e vepimtarisë dhe montimi i teknologjisë dhe pajisjeve veprime që të shkaktojnë ndryshime fizike në topografi, përdorim toke, ndryshime në trupat ujore etj ?				
1.1	Ndryshime të përkohëshme ose të perherëshme në përdorimin e tokës, mbulesen e saj, topografin, duke përfshirë rritjen e intensitetit të përdorimit të tokës	Po	Pjesa e tokës ku ndërtohen kanalet për kullimin e ujërave të shiut dhe rrjetit për vaditjen e parkut	Jo (ndërtimi i kanaleve do të shoqërohet me rehabilitim e tokës)
1.2	Pastrimin e tokës ekzistuese, vegjetacionit dhe ndërtimeve ekzistuese?	Po	Pastrim i tokës ekzistuese dhe vegjetacionit	Jo (ndërtimi i kanaleve dhe hidrovorit do shoqërohet me rehabilitim e tokës)
1.3	Krijimin e përdorimeve të reja të tokës?	Jo		
1.4	Investigime para fazës ndërtimore, si shpime për marrjen e mostrave, provat e tokës, dheut ?	Po	Shpime për marrjen e mostrave të dheut	
1.5	Punime ndërtimi?	Po	Ndërtim i kanaleve	Jo (nuk do ketë ndikim domethënës, sepse do të kthehet në gjendjen fillestare)
1.6	Punime prishjeje?	Po	Prishje të avullive në zonat ku prek gjurma e projektit	Jo (nuk do ketë ndikim, sepse do të rindërtohen sipas projektit)
1.7	Kantiere të përkohëshme për punime ndërtimi ose strehimi për punëtorët?	Po	Kantjer ndërtimi	Jo (do të jetë provizore)
1.8	Punime mbitokesore, struktura ose punime të tokës, gjurmime ose mbushje?	Po	Gërmim kanalesh	Jo (nuk do ketë ndikim domethënës)
1.9	Punime nëntokësore, miniera ose tunele?	Jo		
1.10	Punime bonifikuese?	Po	Punime kullimi	Jo (nuk do ketë ndikim domethënës se janë kanale ekzistuese)
1.11	Gërmime për hapje kanalesh?	Po	Pastrim dhe rehabilitim kanalesh	Jo (nuk do ketë ndikim domethënës)
1.12	Struktura bregdetare, si diga, skela?	Jo		
1.13	Struktura në det?	Jo		
1.14	Procese të ndryshme prodhimi?	Jo		
1.15	Mjedise për magazinim të mallrave e materialeve të ndryshme?	Po	Materiale inerte, çimento, hekur etj.	Jo (do përdoren ambiente provizore në kantjer)
1.16	Impiante për trajnimin ose depozitimin e mbetjeve të ngurta e të lëngëshme?	Jo		
1.17	Objekte të strehimit punëtorëve të shfrytëzimit?	Jo		

1.18	Rrugë e re, hekurudhe, trafik detar, gjatë fazës së ndërtimit e shfrytëzimit?	Jo		
1.19	Rruge e re, hekurudhe, ajrore, ujore, infrastruktura të tjera transorti, përfshirë rrugë e stacione të reja të alternuara porte e aeroporte?	Jo		
1.20	Mbyllje apo devijim i rrugëve ekzistuese që çon në ndryshime në lëvizjet e trafikut?	Jo		
1.21	Linja ose tubacione të reja transferuese të transmetimit?	Po	Kanalet e kullimit	Jo (do të rehabilitohet tereni)
1.22	Rezervuar, argjinatura, kanale nëntokësore, rregullime apo ndryshime të tjera në hidrologjinë e rrjedhave ujore apo akuifereve?	Jo		
1.23	Ndëprerje të rrymave?	Po	Do të vendosen shtylla dhe do të bëhet lidhja për ndriçimin e zonës përgjatë parkut	Jo (nuk ka ndikim domethënës)
1.24	Nxjerje ose transferim të ujit nga nëntoka ose sipërfaqet ujore?	Po	Transferimi i ujrave sipërfaqësor	Jo (nuk ka ndikim domethënës është objekt ekzistues)
1.25	Ndryshime në trupat ujore, sipërfaqet e tokës që ndikojnë në drenimin ose largimin e ujrave?	Po	Largimi e ujrave sipërfaqësor	Jo (nuk ka ndikim domethënës është objekt ekzistues)
1.26	Transportin e personelit e materialeve të ndërtimit, shfrytëzimit e mbeturinave?	Po	Nuk do kenë ndikim mjedisor	Jo (nuk ka ndikim domethënës)
1.27	Punime afatgjata çmontimi, nxjerjen e mbeturinave ose punime restauruese?	Jo		
1.28	Veprimtari gjatë ndryshimit të destinacionit që mund të kenë ndikim në mjedis?	Jo		
1.29	Hyrjen e njerëzve në një zonë përkohësisht ose në mënyrë të vazhdueshme?	Po	Nuk do ketë ndikim mjedisor	Jo (lidhet me aktivitetin ndërtues)
1.30	Futjen për kultivim të specieve jovendase?	Jo		
1.31	Humbjen e specieve vendase ose diversitet gjenetik?	Jo		
1.32	Ndonje veprim tjetër?	Jo		
2. A do përdoren gjatë fazës së ndërtimit dhe shfrytëzimit të projektit burimet natyrore të tilla si: toka, uji, materiale e energji, nga burime që janë të parinovueshme ose të kufizuara?				
2.1	Tokë veçanërisht e varfër apo tokë bujqësore?	Jo		
2.2	Uji?	Po	Nuk do ketë ndikim mjedisor	Jo (sasi e pakët uji për furnizimin e kantjerit)
2.3	Minerale?	Jo		
Pyetje që duhet të mbahen parasysh gjatë përzgjedhjes				
2.4	Grumbullime lëndësh ndërtimi (zhavor etj)	Po	Nuk do ketë ndikim mjedisor	Jo (rehabilitim toke të përdorur pas ndërtimit)
2.5	Pyje dhe lëndë drusore	Jo		
2.6	Energji, elektrike apo lëndë djegëse?	Jo		
2.7	Ndonjë burim tjetër?	Jo		

3. A do të përfshijë projekti përdorimin, ruajtjen, transportin, përpunimin dhe prodhimin e substancave e materialeve që mund të jenë të dëmshëm për shëndetin e njerëzve e mjedisin e risin shqetësimin mbi rreziqet aktuale e të mundshme në shëndetin e njerëzve?				
3.1	A parashikon projekti përdorimin e substancave ose materialeve të rrezikshme ose toksike për njerëzit dhe mjedisin?	Jo		
3.2	Do rezultojë projekti në ndryshime me shfaqje sëmundiesh ose efekt në vektorët e sëmundjeve	Jo		
3.3	Do ndikojë projekti në mirëqenien e njerëzve?	Po	Impakt pozitiv	Rritjen e cilësisë së jetesës , zhvillimin ekonomik të zonës.
3.4	A ka grupe njerëzish që mund të ndikohen nga projekti, si të semurë apo të moshuarit?	Jo		
3.5	Shkaqe të tjera?	Jo		
4. A do të prodhohen mbeturina të ngurta, gjatë ndërtimit, shfrytëzimit ose nxjerje jashtë funksioni?				
4.1	Mbeturina dherash zhavori ose minierash?	Po	Nuk do kenë ndikim mjedisor	Jo (rehabilitohet toka e përdorur pas ndërtimit)
4.2	Mbetje urbane(shtëpiake ose tregetia) ?	Jo		
4.3	Mbetje të rrezikshme e toksike apo radioaktive?	Jo		
4.4	Mbetje të tjera të proceseve industriale?	Jo		
4.5	Produkte shtese?	Jo		
4.6	Ujëra të zeza ose llumra të tjera nga trajtimet e shkarkimeve të lëngëta?	Jo		
4.7	Mbetjet nga ndërtimet ose shembjet?	Po	Nuk do kenë ndikim mjedis	Jo (do të depozitohen në vendet e caktuara)
4.8	Mbeturina makinash ose paisjesh?	Jo		
Pyetje që duhet të mbahen parasysh gjatë përzgjedhjes				
4.9	Toka të ndotura ose materiale të tjera?	Jo		
4.10	Mbetje bujqësore?	Jo		
4.11	Mbetje të tjera të ngurta?	Jo		
5. A do të shkarkohen ndotës në ajër ose çdo substancë tjetër e rrezikshme toksike apo e dëmshme për shëndetin nga projekti?				
5.1	Shkarkime nga djegiet e karburanteve nga burime stacionare ose të levizshme?	Jo		
5.2	Shkarkime nga proceset prodhuese?	Jo		
5.3	Shkarkime nga përpunimi i materialeve, përfshi depozitimin ose transportin?	Jo		
5.4	Shkarkime nga aktiviteti i ndërtimit përfshin impiantet dhe pajisjet?	Jo		
5.5	Mbetje e erera sulmuese nga përpunimi i materialeve të ndërtimit, ujrave të zeza e mbetjet?	Jo		
5.6	Shkarkime nga inceneratorët e plehrave?	Jo		
5.7	Shkarkime nga djegija e mbetjeve në ajër?	Jo		
5.8	Shkarkime nga burime të tjera?	Jo		
6. A do të shkaktojë projekti zhurma dhe vibracione ose emëtime të dritës, energjisë termike ose rrezatim elektromanjetik?				

Raport Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

6.1	Nga puna e paisjeve si: motora, franto,ventilus?	Po	Do ketë ndikim minimal në mjedis	Jo (punimet kryhen me orar të reduktuar)
6.2	Nga proçese industriale apo të ngajshme?	Jo		
6.3	Nga ndërtime apo prishje?	Po	Do ketë ndikim minimal në mjedis nga ndërtimi	Jo (punimet kryhen me orar të reduktuar)
6.4	Nga plasje apo futje pilotash	Jo		
6.5	Nga trafiku gjatë ndërtimit ose shfrytezimit?	Jo		
6.6	Nga proçeset e ndriçimit ose ftohjes?	Jo		
6.7	Nga burimet e rezatimit elektromanjetik (efektet mbi pajisjet dhe njerëzit)?	Jo		
6.8	Nga çdo burim tjetër?	Jo		
7. A do të çojë projekti në rreziqe të ndotjes së tokës, ujit nga shkarkimrt e ndotësave në tokë në kanalizimet e ujrave të bardha dhe të zeza, ujrat sipërfaqësor, nëntokësor,bregdetare ose në detë?				
7.1	Nga përpunimi, depozitimi, përdorimi ose shkarkim i lëndëve të rrezikshme e toksike?	Jo		
7.2	Nga shkarkimet e ujrave të zeza ose rjedhjeve të tjera (trajtuara e patrajtuara) në uji ose tokë?	Po	Do ketë ndikim minimal në mjedis nga derdhja e ujrave të zeza të zonës përreth kanalit	Jo (objekti është ekzistues dhe pas ndërtimit niveli i ndotjes është i njëjtë)
7.3	Depozitimi ndotësve të shkarkuar në ajër, uji toke	Jo		
7.4	Nga çdo burim tjetër?	Jo		
7.5	A ka rrezik të ndonjë akumulimi afatgjatë të ndotësve në mjedis nga këto burime?	Jo		
8. Ekziston rreziku i aksidenteve gjatë ndërtimit apo shfrytëzimit të projektit që mund të ndikojë në shëndetin e njerëzve apo mjedisin?				
8.1	Shpërthime, zjarre, nxjerje nga depozitimi, përdorimi e prodhimi i substancave të rrezikshme e toksike?	Jo		
8.2	Nga ngjarje që kapërcejnë kufijtë e mbrojtjes normale të mjedisit, p sh. dëmtimi i sistemit të kontrollit të ndotjes?	Jo		
8.3	Nga ndonjë shkak tjetër?	Jo		
8.4	Mund të ndikohet projekti nga fatkeqsi natyrore që shkaktojnë dëme për mjedisin (përmytje, tërmete, shkarje etj.)?	Jo		
9. A rezulton projekti me ndryshime sociale, në demografi, mënyrë tradicionale jetese, punësim?				
9.1	Ndryshime në madhësinë e popullsisë, moshën, strukturën, grupet sociale etj.?	Jo		
9.2	Nga strehimi i njerëzve apo prishja e shtëpive, mjediseve të komunitetit, si shkolla, spitale, mjedise sociale?	Jo		
9.3	Nëpërmjet migrimit të banorëve të rinj ose krijimit të komuniteteve të reja?	Jo		
9.4	Nga realizimi i kërkesave në rritje për mjedise, shërbime sociale, strehim, arsim, shëndet?	Jo		
9.5	Nga krijimi i vendeve të punës gjatë ndërtimit a shfrytëzimit apo humbjes së vendeve të punës me pasoja në papunësi e ekonomi?	Po	Impakt pozitiv	Impakt pozitiv nga hapja e vendeve të punës.
9.6	Ndonjë shkak tjetër?	Jo		

10. A do të çojë projekti në presion për zhvillime të mëtejshme që mund të kenë ndikim të rëndësishëm në mjedis, me shumë banesa, rrugë të reja, industri, veprimtari mbështetëse				
10.1	A do të çojë projekti në presione për zhvillime të mëtejshme që do të ketë ndikim të caktuar në mjedis, si: më shumë strehim, rrugë të reja, industri, shërbime publike mbështetëse të reja?	Po	Impakt pozitiv	Ritje të cilësisë së jetesës dhe zhvillim të industrisë.
10.2	A do të çojë projekti në zhvillimin e mjediseve mbështetëse, zhvillime ndihmëse ose zhvillime të nxitura nga projekti që të ketë ndikim mjedisi , si: 1. infrastrukturë mbështetëse (rrugë, furnizim me energji elektrike, trajtim të mbetjeve ose ujrave të përdorura etj.) 2. Zhvillim i strehimit; 3. industri nxjerrëse (ekstraktuese); 4. industri funizuese; 5. të tjera	Jo Jo Jo Jo		
10.3	A do të çojë projekti në ripërdorim të kantjerit pas shfrytëzimit të tij që do të ketë ndikim në mjedis?	Jo		
10.4	A do të çojë projekti në krijimin e një precedenti për zhvillime të mëvonshme?	Po	Impakt pozitiv	Për zhvillim ekonomik të zonës.
10.5	Do ketë projekti pasoja kumulative nga afërsia me projekte të tjera ekzistuese ose të planifikuara e me pasoja të ngjashme?	Jo		

9. ANALIZA E GJËNDJES EKZISTUESE DHE VLERËSIMI I SITUATËS

9.1 Ndikimet në mjedis gjatë ndërtimit

Për ndërtimin e këtij projekti do të kryen këto punime: gërmimi për hapje kanalesh, punime hekuri dhe betoni, Punime shtresash, punime gjelbërimi, punime elektrike si dhe përdorim të makinerive teknologjike, gërmuese dhe transportuese, etj. Pra gjatë kryerjes së këtyre operacioneve do të ketë krijim të pluhurave në sasira të vogla si rezultat i punimeve të ndryshme. Për të bërë të mundur reduktimin në minimum të pluhurave gjatë transportit është e domosdoshme që makina transportuese të mbulohen.

9.2 Ndikimet në mjedis gjatë largimit të materialeve nga kanalet, ndërtimi i rrugëve, shkallareve etj

Terreni nëpër të cilin do të kalojnë kanalet, rrugët, tregon se kemi të bëjmë me punime gërmime. Pjesa më e madhe e materialeve të gërmimit do të largohen nga kanalet do të depozitohen në vendin e përcaktuar nga pushteti vendor. Pikërisht pushteti vendor duhet të caktojë vendin e përshtatshëm ku do të depozitohen pa shkaktuar ndotje të tjera në mjedis.

9.3 Ndikimet në mjedis si rezultat i sjelljes së materialeve të ndryshme

Megjthëse kemi të bëjmë me hapje kanalesh , shtrim rrugësh , ndërtim shkallare , ndërtim gardhe , F.v Shtylla elektrike do të kemi volume të konsiderueshme materialesh ndërtimi (rërë, zhavor, tuba, rakorderi, beton etj.) që do të sillen për nëpërmjet makinave të tonazhit të lartë, të mesëm dhe të vogël sipas rastit. Të gjitha këto makina do të rrisin trafikun dhe nivelin zhurmave. Është menduar që punimet të kryhen në orar të kufizuar nga ora 07.00-15.00.

9.4 Vlerësimi i efektivitetit të pritshëm të masave zbutëse

Realizimi i objektivave dhe treguesve të pritshëm të parashikuar në projektin e ndërtimit do të varet nga respektimi i treguesve të përcaktuar në këtë raport. Kontrolli i monitorimit dhe përmirësimi i vazhdueshëm, sipas kushteve të shfrytëzimit të krijuar gjatë aktivitetit, do të çojë përfundimisht në përfitimin e pamjeve të parashikuara në projekt.

9.5 Zhurmat

Gjatë ndërtimit, do të ketë angazhim të makinerive për punime gërmimi, montimi, transporti materiale, etj. Për të zbutur efektin e trafikut të ngarkuar dhe zhurmave që shoqërojnë atë, me qëllim uljen e shqetësimeve për popullatën përreth zonës së ndërtimit, si rrugë kantjerit do të përdoren ku të jetë e mundur rrugët dytësore. Projekti parashikon rrugë aksesit për hyrjen në park me seksione të ndara duke i dhënë akses çdo banesë që ndodhet përgjatë parkut. Transportimi i materialeve të ndërtimit në rrugët do të programohet me kujdes për të shmangur çdo shqetësim në trafikun lokal. Gjatë natës, automjetet e transportit të materialeve do të kërkohet që të operojnë me shpejtësi të ulta dhe do të ndalohej përdorimi i borive.

9.6 Ndikimet në ujrat sipërfaqësore

Zbatimi i këtij projekti nuk lë shkas për ndotjen e ujërave të rrjedhës sipërfaqësore nga ndotës të ndryshëm si karburantet, lëndet helmuese etj. Nuk pritet të ndodhë ndonjë ndotje nga shkarkimet në tokë, e më pas të shpëlahen nga rreshjet, ndërsa nga karburantet mund të ketë vetëm ndotje aksidentale nga rrjedhja e mjeteve të punës.

9.7 Ndikimet në ujrat nëntokësore

Zbatimi i projektit nuk ka ndikim në ujtat nëntokësore, pasi projekti do të vendoset në gjurmën ekzistuese të kullimit.

10 PLANI I ZBUTJES SË NDIKIMEVE NEGATIVE DHE REHABILITIMET

10.1 Përdorimi tokës

Ndërtimi i rrjetit të kullimit, rrugëve, nuk krijon shqetësim për komunitetin përreth gjatë fazës së shfrytëzimit por shqetësime në fazën e ndërtimit që lidhen me trafikun, zhurmat dhe pluhurin. Gjatë punimeve të ndërtimit nuk do të krijohen dëmtime të tokës. Për sa i përket tubacioneve ato nuk japin ndonjë ndryshim në peisazh, për arsye se ato janë punime në gjurmë dhe kanale ekzistuese. Duhet të theksojmë edhe njëherë se i gjithë rrjeti nuk vendosen në tokë buke, por vetëm në kanalin ekzistues.

Gjithashtu punimet për rrugët, korsitë e biçikletave do të japin një ndryshim pozitiv në peisazh, pasi do të sistemohen hapësirat publike.

10.2 Ndikimi tek njerëzit, ndërtesat dhe objektet e ndërtuara nga njeriu

10.2.1 Ndikimi në popullsi

Ndërtimi i parkut në këtë zonë ka për të patur një ndikim pozitiv në komunitetin e kësaj zone. Realizimi i këtij projekti, do të sjellë tendencën për zhvendosjen e popullsisë në këto zona duke qënë sa më afër zonës së rekreacionit. Duhet theksuar që do të ketë impakt pozitiv edhe në objektet e ndërtuara në këtë zonë, pasi aktualisht ka ndërtime si pallate ende të pabanuara, që me ndërtimin e parkut dhe zhvillimit të zonës do të rritet interesi i popullsisë për investime në këtë zonë.

Ndërkohë duhet të theksojmë që ndërtimi i parkut, do të ketë avantazhe të medha, jo vetëm për biznesin, por dhe për turizmin e kësaj zone. Planet në perspektivë për shtrirjen që do të ketë zonë në një të ardhme të afërt, kjo e bazuar dhe në studimin urbanistik të miratuar.

Ndërkohë duhet theksuar dhe fakti që në këtë aktivitet mendohen të punësohen një numër i konsiderueshëm punonjësish duke zbutur e papunësinë në muajt e dimrit kur mungojnë pushuesit.

10.2.2 Ndikimet në peisazh

Kemi theksuar se karakteristike e ndërtimit të një parku, është krijimi i një peisazhi të gjelbërt dhe krijimi i hapësirave rekreative dhe mjedisit turistik të saj, prandaj peisazhi ka për të patur një ndikim pozitiv në përmirësimin e tij.

10.3 Ndikimet e rrjetit mbi trashgimë arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe vepra të tjera njerëzore

Projekti shtrihet mbi kanalën ekzistuese të kullimit dhe ujrave të larta me thellësi deri 5m, nuk ka për të patur dhe nuk do të ketë ndikime negative mbi trashgiminë arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe mbi vepra të tjera njerëzore, sepse në zonë dhe përreth saj, nuk ka objekte të një rëndësie të veçantë të karaktereve të mësipërme. Për shkak se rrugët janë ekzistuese dhe janë shtruar rrjete inxhinierike në periudha të ndryshme janë identifikuar zonat me potencial të lartë dhe për këtë arsye do të mbikqyren nga një ekspert arkeolog i licencuar gjatë zbatimit të punimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

10.4 Ulja e intensitetit të erozionit dhe zbutja e ndryshimeve të topografisë

Qëllimi i projektit lidhet me ndërtimin e rrjetit të kullimit të ujrave sipërfaqësor. Ndër objektivat të këtij aktiviteti është largimi i ujrave të shiut dhe evitimi përmytjeve.

11. NDIKIMET NË FLORË, FAUNE DHE GJEOLOGJINË

11.1 Flora dhe Fauna

Zona siç është përshkruar edhe më lart, nuk është e mbushur me bimësi, përveç zonës së varrezave. Fauna e zonës, nuk pëson ndonjë ndryshim të ndjeshëm nga ky projekt. Aktiviteti i ndërtimit të parkut sjell në impakt pozitiv në rritjen dhe zhvillimin e florës dhe faunës së zonës përreth. Ndërtimi i parkut ka si objektiv ndërtimin e hapësirave të gjelbërta me mbjelljen e pemëve të

ndryshme, gjë që do të sjellë impakt pozitiv në florën e zonës përreth si edhe të faunës ku me mbjelljen e pemëve do të kemi edhe zhvillimin e faunës në këtë zonë.

11.2 Humbja dhe dëmtimi i tipareve gjولوجjike, paleontologjike, problemi i mjedisit gjeologjik

Në pikëpamje të strukturës gjeologjike dhe pamjes së relievit, kjo zonë nuk ka veçori tipike dalluese dhe nuk ka asnjë arsye të vlerësohet ose të merret parasysh gjatë këtij aktiviteti. Kjo zonë përbën një peisazh të zakonshëm gjeologjiko-gjeomorfologjik, katakteristike e këtij rajoni.

12. NDIKIMET E PRITSHME NË MJEDISIN PËRRETH

12.1 Ndikimet fizike të projektit në ndryshimet e topografisë së zonës, tokës, etj.

Gjatë ndërtimit të parkut urban, do të ketë ndryshime të topografisë lokale kryesisht do të kemi mbushje të terrenit përgjatë parkut për të arritur kuotën e projektit. Në projektet janë parashkuar një rrallë ndërhyrjesh që, në kombinim me masat e tjera suplementare të sistemimit dhe trajtimit, parandalojnë erozionin e mundshëm. Gjatë ndërtimit të kanaleve, dhe tubacioneve nuk pritet të ketë ndryshime në topografinë lokale. Në projekt është parashkuar një rradhë pune dhe drejtim i tillë, që në kombinim me masat e tjera suplementare të mbushjes, sistemimit dhe trajtimit, të parandalojnë fenomenin e erozionit:

- Ndikimet në përdorimin e tokës dhe të burimeve,
- Në cilësinë dhe sasinë e tokës arë,
- Shtimin e zonave të gjelbërta përgjatë gjithë gjatësisë së tokës në zonën ku do të kryhet investimi.

Sipërfaqja që do të përdoret për ndërtimin e kanaleve është ekzistuese. Pra nuk kemi të bëjmë me toke bujqësore. Ndërtimi i këtyre veprave hidroteknike në këtë zonë, nuk ndikon negativisht në cilësinë dhe sasinë e tokës arë. Në zonën e ndërtimit, hap pas hapi është parashkuar sistemimi i terrenit dhe si pasojë zhvillimi i bimësisë të kësaj zone.

12.2 Në cilësinë dhe sasinë e tokës

Sipërfaqja në të cilën do të ndërtohet parku urban, nuk është tokë bujqësore. Ndërtimi i këtij parku nuk përbën asnjë problem për sa i përket cilësisë së tokës.

12.3 Ndikimet në ujë

Ndërtimi i rrjetit, nuk sjell asnjë ndikim cilësinë së ujit, pasi ai është ekzistues. Projekti nuk do të ndikojë negativisht në ujrë sipërfaqësore që përdoren për vaditje nga komuniteti i afërt, pasi veprat janë ekzistuese. Zbatimi i projektit nuk do të ndikojë negativisht në ujrë sipërfaqësore.

12.4 Ndikimet e ndotësve dhe mbetjeve në cilësinë e ujit

Gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti nuk do të ketë ndikim në cilësinë e ujit.

12.5 Ndikimet në ajër

Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk ka ndikim në cilësinë e ajrit të zonës, mbasi gjatë shfrytëzimit nuk do të ketë emërtime të gazrave dhe pluhurave.

12.6 Ndikimi në klimë

Gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti nuk ka ndikim në klimën e kësaj zone.

12.7 Aromat sulmuese

Gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti nuk ka emetime të aromave të ndryshme të çdo lloji qofshin ato.

12.8 Ndikime të tjera klimatike

Gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti nuk ka ndikim në klimën e kësaj zone.

12.9 Ndikime të tjera indirekte dhe sekondare, që shoqërojnë projektin

Projektet e tjera si p.sh. rrugët e reja, kanalet e ujrave të zeza, banesat, linjat e energjise, telekomunikacionet, etj. do të ndikojnë në realizimin e këtij projekti, pasi në zonën që prek ky projekt ka elementë të infrastrukturës siç u përmendën më lart por janë bërë të gjitha azhornimet e tyre dhe do të synohet shmangia e intersektimit të tyre.

12.10 Ndikimet shoqëruese të projektit me projekte të tjera ekzistuese ose të propozuara

Ushtrimi i këtij aktiviteti do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin dhe në rritjen e nivelit socia-ekonomik në zonë.

d) *informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar;*

Ndikimet e pritshme janë gjatë fazës së ndërtimit si zhurma, trafik, pluhur dhe inerte. Për të gjitha këto ndikime të pritshme është parashikuar ndalimi i borive dhe kufizim i lëvizijes së mjeteve në orarin 7.00-15.00. Për të ulur trafikun në rrugë në segmenete ku do punohet do të vendoset personel me flamur për menaxhimin e trafikut. Për të eleminuar pluhurin do të laget rruga me qëllim uljen e pluhurit në ajër gjatë punimeve. Për inertete e nxjera nga gjurmimi dhe që nuk do të përdoren do të depozitohen në vendgrumbullimin e miratuar nga pushteti vendos në përputhje me VKM.

dh) *të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;*

Nuk pritet të ketë ndikim negative në hapësirën në afërsi të projektit pasi madhësia e projektit është shumë e vogël për të ndikuar në zonën në afërsi të saj

e) *mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;*

Për rehabilitimin e mjedisit është parashikuar në preventiv kthimi rrugëve në gjendjen e mëparshme duke i shtruar rrugët ekzistuese sipas rastit me asfalt ose me stabilizant.

ë) *masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;*

1)Perdorimi tokës

Ndërtimi i parkut Urban Spitallë , nuk krijon shqetësim për komunitetin përreth gjatë fazës së shfrytëzimit por shqetësimet në fazën e ndërtimit që lidhen me trafikun, zhurmat dhe pluhurin. Punimet e ndërtimit do të vazhdojnë për një periudhë të vogël kohe dhe nuk do të krijohen dëmtime të tokës. Për sa i përket tubacioneve ato nuk japin ndonjë ndryshim në peisazh, për arsye se ato janë punime plotësisht nëntoke dhe

nuk duken në sipërfaqe. Ndërsa duhet të theksojmë që përmasat e kanaleve të tubave janë të vegjël me një gjerësi 0.6-0.65 m dhe thellësi rreth 1.2-1.4 m. Duhet të theksojmë edhe njëherë se i gjithë rrjeti nuk vendosen në tokë buke.

12.11 Ndikimi tek njerezit, ndërtesat dhe objektet e ndërtuara nga njeriu

Ndikimi në popullsi

